

Konsultime nacionale me komunitetet fetare mbi themelimin e

Komisionit rajonal për përcaktimin e fakteve të të gjitha viktimave të luftërave në Ish - Jugosllavi nga 1991 – 2001 (KOMRA)

Prizren, Hotel Theranda
29.07.2010.

- 10:00 -10:30 **Hapja e takimit**
Moderator: Bekim Blakaj, Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë
- Ruzhdi Rexha, Nënkryetar i Komunës së Prizrenit
Nataša Kandić, Fondi për të drejtën humanitare, Beograd
- Prezentimi i pjesëmarrësve**
- 10:30 – 10:45 **Përse KOMRA?**
Veton Muja, Syri i Vizionit, Kosovë
- 10:45 – 11:00 **Dokumentar: Komisioni i Marokos**
- 11:00 – 11:15 **Rrjedha e procesit konsultativ mbi Iniciativën për KOMRA**
Nataša Kandić, Fondi për të drejtën humanitare, Beograd
- 11:15 – 11:45 **Pauzë**
- 11:45 – 12:00 **Roli i bashkësive fetare në procesin e pajtimit**
Prof. Ismajl Hasani, Sociolog i religjioneve
- 12:00 – 14:00 **Diskutime**
Moderator: Bekim Blakaj, Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë
- 14:00 **Dreka**

Bekim Blakaj: Mirëdita, të gjithëve!

Zonja dhe zotërinj, ju kisha bërë të ditur se përkthimet janë, në kanalën e parë në gjuhën shqipe, kurse në atë të dytën në gjuhën serbe. Do të kishim pritur edhe për një minutë edhe disa pjesëmarrës, që posa arritën. Edhe një herë, në emër të Fondit për të Drejtën Humanitare dhe në emrin e Koalicionit për KOMRA-n ju dëshiroj mirëseardhje të gjithëve. Të nderuar përfaqësues të komuniteteve fetare, I nderuari zëvendëskryetar i Komunës së Prizrenit, zotëri Rexha, I nderuar profesor Hasani, Këto janë konsultimet e para në Kosovë me bashkësitë fetare lidhur me themelimin e komisionit rajonal për përcaktimin e fakteve për krime të luftës dhe për shkelje të rënda të drejtave të njeriut në ish-Jugosllavi. Ky proces ka filluar qysh në vitin 2006 me konsultime të ndryshme, dhe së pari me organizata joqeveritare për të drejta të njeriut e pastaj edhe me organizata e individë me profesione të ndryshme, me juristë, me gazetarë, me pjesëtarë të komunitetit të artistëve e kështu me radhë në mënyrë që të debatohet për nxjerrjen e një mekanizmi i cili do të ballafaqohet me të kaluarën dhe do të nxirrte faktet për krimet e luftës. Në vitin 2008 zyrtarisht është krijuar koalicioni i organizatave joqeveritare të cilat e përkrahin këtë ide dhe deri më tash janë më se 900 organizata joqeveritare dhe individë të cilët qëndrojnë pas kësaj nisme për krijimin e këtij komisioni. Meqenëse ne do ta japim një pasqyrë të detajuar mbi rrjedhën e konsultimeve të deritanishme për inicimin e këtij komisioni, edhe kolegu ynë Veton Mujaj do ta jap një shpjegim për çështjen se pse ne na duhet ky komision, prandaj edhe nuk do të zgjas më shumë dhe do ta lus zëvendëskryetarin e komunës së Prizrenit, zotëri Rexha që të na drejtohet si nikoqir me një fjalë rasti. Zotëri Rexha, urdhëroni!

Ruzhdi Rexha: Faleminderit shumë, zotëri Bekim!

Zonja dhe zotërinj, vëllezër e motra, Si fëmijë kur isha, gjithnjë i vogël, prindërit dhe shokë gjithnjë më thonin: mos dil para njerëzve fetarë se janë më të zotë se ti?! Mirëpo, më lejoni që në disa minuta vetëm ta bëj prezantimin e qytetit të Prizrenit. Nëse me përkthyes kemi problem, fjalimin tim po ashtu e kam bërë gati edhe në gjuhën serbe që nuk është problem, nëse doni më vonë do ta lexoj. Të nderuar përfaqësues të komunitetit fetar të Kosovës, dhe atë nga Bashkësia Islame; Kishës Katolike; Kishës Ortodokse Serbe, Kishës Evangjeliste; Kishës Protestante, Kishës Adventiste, Të nderuar teologë të pavarur, si dhe laikë të religjioneve të përmendur, e nderuar zonja Kandiq, si dhe ju të nderuar të pranishëm. Me marrjen e ftesës nga zonja apo zonjusha Nora dhe zotëri Bekimi për pjesëmarrjen time në konsultimet fetare në Kosovë, në atë ftesë përveç të tjerash, është cekur: “Është zgjedhur si lokacion qyteti i lashtë i Prizrenit, i cili në thelb paraqet njërin prej vendeve më paqësor si dhe shembull tipik të tolerancës ndër-fetare”. Këto fjali, janë dëshimi mbi njohuritë tuaja për qytetin e Prizrenit, kurse çka më mbet mua, përveç të dëshmoj dhe përsëris këto fjali të njëjta. Të gjithë të pranishmëve iu dëshiroj mirëseardhje në qytetin muze – Prizrenin, i cili ka sipërfaqe diku afër 640 kilometra katrorë dhe i njëjti mbulon afër 6% të tërë territorit të Kosovës. Ka 76 vendbanime dhe rreth 220 deri 260 mijë banorë, ku 50% të banorëve jetojnë në qytet dhe 50% të tjerë jetojnë në vendet rurale. Diku afër 90% të popullatës janë të komunitetit boshnjak, turk, serb dhe të tjerë. Në kohët e kaluara Prizreni ka përjetuar shumë të hidhura, ndryshime në sfera të ndryshme që kanë ndikuar në zhvillimin kulturor dhe ekonomik. Qyteti i Prizrenit njihet si vendlindja e Ilirëve, apo e Dardanëve. Gjatë periudhës romake është njohur me emrin Therandë. Gjatë periudhës bizantine është njohur me emrin Prizrian. Në dokumentet osmane njihej me emra Terzaliu, Eperserin, e tjera. Në mijëvjeçarën e dytë ishte mbretëri sllave. Në vitin 1204, Prizreni është okupuar nga forcat bullgare, ndërsa më vonë pushtohet edhe nga serbët. Meqë Prizreni ishte qendër iliro-dardane, me shekuj prezantojë shpirtin e kulturës dhe arkitekturës shqiptare andaj prej të gjithë atyre tentativave të superfuqive për ndryshimin e identitetit dhe fizionomisë antike të Prizrenit, bekimi i zotit ka bërë të mbetet i njëjtë, bile edhe më i bukur. Në qytetin e Prizrenit njerëzit janë të

besimit katolik, ortodoks, mysliman, hebrenj, protestant dhe të tjerë dhe me shekuj radhazi ka zotëruar harmoni vëllazërore dhe fetare. Si shembull i harmonisë mund të na shërbejë mënyra e manifestimit të festave të myslimanët apo të katolikët. Ju sigurisht jeni të njoftuar dhe kjo është traditë në tërë Kosovën që gjatë festave të Bajramit, apo të Pashkëve, apo Krishtlindjeve nuk ka asnjë katolik apo asnjë mysliman që nuk shkon te vëllai i vet e t'ia uroj festën. Kjo është një traditë edhe në qytetin e Prizrenit, dhe që nuk anashkalohet kurrsesi. Mirëpo, nga ana tjetër, po ashtu kemi edhe shembuj të veçantë, bie fjala edhe kur bëhet falja e Bajramit apo të festave të tjera, kur shkojnë në xhami shkojnë edhe komuniteti boshnjak, shkon edhe komuniteti turk, shkon edhe komuniteti shqiptar në xhami. Nuk kemi dallime. Kjo ndikon shumë në marrëdhëniet ndërjetare, kur na ka bashkuar vendi dhe kulti. E lus zotin që kjo harmoni dhe tolerancë vëllazërore dhe fetare, që është në qytetin e Prizrenit, të jetë shembull për të gjithë njerëzimin dhe të zgjasë përgjithmonë! Edhe një herë, ju falënderoj për nderin që na e keni bërë dhe ju dëshiroj një qëndrim të këndshëm në qytetin e lashtë dhe modern si dhe gjithnjë të dashur për të gjithë njerëzit e mirë. Ju priftë e mbara! Verujem da ste me svi razumeli, i nadam se da je prevod bio u redu!

Bekim Blakaj: Ju faleminderit edhe një herë, zotëri Rexha! Tani do ta marrë fjalën, zonja Natasha Kandiç!

Nataša Kandić: Mirëdita te gjithëve! Ju përsëndes në emër të Koalicionit për formimin e komisionit regjional për përcaktimin e fakteve të krimeve të luftës si dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut, përcaktimin e fakteve për të gjitha viktimat. Koalicioni cili është formuar në vitin 2006 sot numëron 900 organizata, shoqata të viktimave, grupe tjera të shoqërisë civile, shoqata profesioneve të ndryshme, individëve, sidomos shoqatat e viktimave dhe koalicione të cilat i lidhe një interes i përbashkët dhe aj është ballafaqimi më të kaluarën dhe të gjithë pajtohen me këtë, kjo na lidhë, koha është të flitet për të kaluarën në bazë të fakteve, duhet respektuar të gjitha viktimat. Vërteta dhe faktet për të gjitha viktimat dhe se vetëm në bazë të fakteve mund të ndërtohet një garanci që në hapësirë të Ballkanit nuk do të përsëritet krimi. Në kuadër të koalicionit janë organizatat, anëtar të cilët kanë aktivitete të ndryshme por ky është një qëllim i përbashkët të gjithë pajtohemi që më detyrën e përbashkët të formohet një komision i dedikuar viktimave ku bashkësitë fetare do të kanë një rolë të veçantë. Unë pastaj do të flas për konsultime dhe debate me bashkësitë fetare në rajon të cilat janë mbajtur deri më tani, dhe besoj që do të janë të rëndësishme. Tani propozoj siç kemi bërë në të gjitha konsultime që së pari të prezantohen të gjithë pjesëmarrësit, fillojmë nga Nora...

Nora Ahmetaj: Unë jam Nora Ahmetaj, anëtare e Këshillit koordinues të Koalicionit për themelimin e komisionit rajonal në ish Jugosllavi.

Sejdi Sallahu: Unë jam Sejdi Sallahu, Këshilli i Bashkësisë Islame, nga Suhareka, kryeimam në Këshillin e Bashkësisë Islame Suharekë.

Lutfi Ballëk: Jam Lutfi Ballëk, kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame në Prizren.

Fitim Flugaj: Përsëndetje të gjithëve! Jam Fitim Flugaj, nga Kryesia e Bashkësisë Islame, zyrtar i Bashkësisë Islame, Prishtinë.

Ramadan Shkodra: Jam Ramadan Shkodra, zyrtar i Bashkësisë Islame...

Fatmir Iljazi: Përsëndetje! Fatmir Iljazi, kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame, Gjakovë.

Artuar Krasniqi: Përsëndetje! Nga Kisha Protestante Evangjeliste të Kosovës, Prishtinë.

Bekim Beka: Përsëndetje! Bekim Beka, nga kisha protestante evangjelistë në Kosovës në Prishtinë.

Lule Potera: Përsëndetje! Lule Potera, nga kisha protestante evangjelistë në Kosovës në Prishtinë.

Besim Kryeziu: Përshëndetje! Besim Kryeziu, nga Kisha Protestante evangjelistë. të Kosovës, po ashtu edhe në Prizren.

Artan Zeka: Jam Artan Zeka, imami në qytetit e Pejës.

Kujtim Paqaku: Përshëndetje! Kujtim Paqaku, përfaqësues i komunitetit rom në kabinetin Presidentit të Kosovës.

Sakibe Jashari: Përshëndetje të gjithëve! Sakibe Jashari, pranë Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

Liridon Kadriu: Liridon Kadriu, orientalist dhe gazetar i pavarur.

Muzafer Shkodra: Muzafer Shkodra, orientalist dhe njëkohësisht student i shkencave juridike.

Alfred Kinolli: Alfred Kinolli, nga qendra rinore Fisniket.

Frok Kristaj.

Pal Canaj: Pal Canaj, profesor i filozofisë dhe sociologjisë në Gjimnazin Luigj Gurakuqi në Klinë.

Ajni Sinani: Ajni Sinani, jam teolog, pranë instituti islam dhe njëkohësisht magjistër i mardhnjeve ndërkombëtare

Lorenc Pitaqi: Lorenc Pitaqi, aktivist i kishës katolike njëkohësisht dhe student i fakultetit juridik .

Agron Lleshaj: Aktivist i Kishës Katolike, student i gazetarisë.

Murgu Teodor: Une jam murgu Teodor, nga manastiri ortodoks serb në Deçan, momentalisht në detyrë në Prizren.

Murgu Nifon: Mirëdita të gjithëve! Pershendetje! Unë jam murgu Nifon, gjithahtu nga Manastiri në Deçan, pranë kishës ortodokse Rashk-Prizren.

Jeton Blakaj: Administrator në Shoqatën Koplik Kosova.

Don Jeton Thaçi: Përshëndetje të gjithëve! Unë jam Don Jeton Thaçi, prift katolik, që shërbej këtu në Prizren, dhe njëherit redaktor i revistës Ibish Dolaj Drita.

Don Pal Tunaj: Përshëndetje të gjithëve! Unë jam Don Pal Tunaj, e përfaqësoj Kishën katolike.

Veton Mujaj: Veton Mujaj, “Syri i vizionit” Pejë, njëkohësisht anëtar i Këshillit koordinues për Iniciativën KOMRA.

Ismajl Hasani: Përshëndetje te gjithëve! Unë jam Ismajl Hasani, doktor i shkencave të sociologjisë religjionit. Një kohë të gjatë profesor në njërin prej universiteteve në Norvegji, tani jam drejtues i një projekti për themelimin e universitetit të shkencave sociale humanistike. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit! Unë kisha lutur edhe pjesëmarrësit tjerë, që janë ulur prapa atje, nëse kanë mundësi të na prezantohen.

Anton Çetta: Përshëndetje! Unë jam Anton Çetta, Kisha Katolike Prizren.

Ana Spaçi: Ana Spaçi, nga Prizreni.

Jak Delhysa: Përshëndetje! Jak Delhysa, nga Kisha Katolike Prizren.

Muhamet Cangati, prej Prizrenit, zyra ndërkombëtare civile. Faleminderit!

Andriana Čavić, Zyra Ndërkombëtare Civile Prizren.

Nenad Popović: Mirëdita të gjithëve unë jam Nenad Popović, i biri i të ndjerit Dragan Popović nga Klina i cili është i vrarë pas kthimit në vitin 2006.

Bekim Blakaj: Faleminderit, të gjithëve! Tani do ta marrë fjalën Veton Mujaj, i cili do të na fletë lidhur me atë se përse komisioni rajonal për përcaktimin e fakteve të krimeve. Veton Urdhëroni!

Veton Mujaj: Faleminderit, Bekim! Përshëndetje për të gjithë! Jam i nderuar që jam para juve. E përmendi fillimisht Natasha se si ka qenë, si është nisur kjo iniciativë, mirëpo pse – pse një iniciativë e tillë? Dimë se gjatë kësaj periudhe, kryesisht në periudhën pas luftës në Kosovë, kemi

dëgjuar shumë edhe për Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës, por kemi dëgjuar edhe për shumë gjykime tjera vendore mirëpo realisht kjo iniciativë ka të bëjë pak më shumë mbi të gjithë atë se çka ka ndodhur, do të thotë edhe për krimet e luftës por edhe viktimat që i kemi pasur dhe në njëfarë forme ideja është që në të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë ku ka ndodhur lufta për këto vende të krijohet një fotografi e qartë të asaj se çka ka ndodhur. Pra, nuk është që vetëm të kemi një koreografi por në njëfarë forme të krijohet edhe një lloj vëmendjeje e publikut ndaj këtyre viktimave. Dimë se gjatë kësaj kohe viktimat në njëfarë forme, në shumë raste, e ndiejnë veten të vetmuar, edhe pse janë bërë disa përpjekje, do të thotë popullata në përgjithësi në njëfarë forme nuk ka mund t'i bashkëngjitet dhimbjeve të mëdha që ka pasur ndaj këtyre viktimave, kështu që një iniciativë e tillë bën të mundur, sipas mendimit tonë, që të gradualisht edhe opinioni i përgjithshëm qytetarëve të gjitha këtyre vendeve të jetë më afër nevojave dhe veprimeve që duhet bërë për këto familje dhe për këto viktimat. Për mendimin e themeluesve dhe zakonisht gjatë gjithë procesit sa është biseduar, një iniciativë e tillë për themelimin e një komisioni rajonal është një rrugëdalje për kalimin nga një fazë e tanishme, do të thotë për përfundimin e një të kaluarë.

Kjo është një iniciativë e Koalicionit rajonal të organizatave joqeveritare, shoqatave të viktimave, të invalidëve të cilët e propagandojnë formimin e komisionit zyrtar. Të gjitha këto organizata, këta individë në njëfarë forme e propagandojnë, kanë dëshirë dhe e shohin si të nevojshme krijimin e një komisioni të tillë rajonal, e cili do të ishte i pavarur, i cili do të konstatojë edhe publikisht të komentojë faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të të drejtave në vendet e ish-Jugosllavisë, përfshirë ndriçimin e fatit të personave të pagjetur dhe gjetjen e tyre ose gjetjen e mbetjeve mortore. Ka shumë qëllime dhe shumë aspekte të cilat mund të mbulohen, do të thotë me krijimin e një komisioni të tillë. Po ajo që shihet si formë është krijimi i një platforme publike për viktimat dhe shoqëritë civile të cilat flasin për nevojat dhe obligimet e veta në raport me padrejtësisë, të kryera në të kaluarën:

- Rritja e mbështetjes së iniciativës për KOMRA-n të përfaqësohet edhe nga autoritetet e vendeve të dala nga Jugosllavia;
- Ndërtimi i një modeli për KOMRA-n, për këtë komision,
- Formimi i debatit me bashkësitë lokale dhe vendosja e komunikimit ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore për të gjithë atë që ka ndodhur në të kaluarën;
- Krijimi i klimës për ndryshime shoqërore, në raport me viktimat;
- Nxitja e bashkëndjesisë dhe solidaritetit ndaj viktimave dhe bashkësive tjera etnike.

Këto janë, do të thotë 5 elemente gati dhe thuaja më kryesore me të cilat në njëfarë forme mund të rritet ajo bashkëndjenja dhe solidariteti me këto viktimat, jo vetëm e njerëzve që direkt merren me këtë punë por në njëfarë forme edhe e gjithë qytetarëve të këtyre vendeve. Pse një komision i tillë? Dihet se shumë gjëra shpesh komunikohen prej shteti në shtet dhe asnjëherë ndoshta nuk janë bash reale me të cilat duhet të përballohem. Formimi i një komisioni të tillë mund të pengojë që në opinion të paraqiten gënjeshtër të caktuara, ose nëse veç janë në pah këto gënjeshtër dhe se janë duke u qarkulluar mund të thuhet se nuk janë kredibile këto gënjeshtër ose mund të vjen deri te një e vërtetë me të cilën tregohet se a janë kredibile, a është një gënjeshtër apo është e vërtetë kjo që po qarkullon nëpër këto shtete. Mund të ndihmojë platformën publike për zërin e viktimave dhe me ndihmën e zërave të viktimave të nxisë opinionin për një

bashkëndjehje, respektim dhe solidaritet jo vetëm me viktimat të cilat tanimë bashkëndjehen në mes veti por edhe me viktimat të cilat në të kaluarën nuk kanë mund t'i shohin si viktimë. Në njëfarë forme shpesh një etni tjetër, ne nuk kemi mund ta shohim si viktimë, por realisht nëpër shumë vende të tyre shumë etnitete të ndryshme janë viktimë në formave të veçanta, në njëfarë forme një rritje e përgjithshme e zërit të viktimave bën që edhe viktimat, të zëmë të Kosovës, mund të bashkëndjehen me viktimat e Bosnjës ose me viktimat e Kroacisë, apo të vendeve tjera. Do të thotë, në njëfarë forme duket që shpesh ne mendojmë në Kosovë se vetëm në Kosovë ka pasur luftë, mirëpo njëkohësisht dimë çka ka ndodhur në Bosnjë dhe dimë çka ka ndodhur në vende të tjera, kështu që një zë pak më i fuqishëm i të gjithëve mund të bëhet dhe t'i bashkëngjitet një bashkëndjenje për viktimën. Një element tjetër i veçantë i cili mund të bëhet nëse krijohet kjo, është që mund ta kemi një regjistër të viktimave dhe të njerëzve të humbur dhe me këtë njëherë e përgjithmonë të pengojmë manipulimin me numrin e atyre se sa kanë pësuar ose sa janë të vrarë. Shpesh me këto shifra luhet. Do të thotë është mundësia dhe e dimë që për afërsisht është bërë edhe një punë në këtë drejtim, por jo konkrete deri tash, mirëpo kishte me pas mundësi që konkretisht dhe saktësisht të dihet ku dhe sa viktimë janë të vrarë, dhe për të gjitha aspektet tjera. Mund t'u ndihmojë prokurorive për krime të luftërave duke iu siguruar prova, me inkurajimin e dëshmitarëve të viktimave për të marrë pjesë në gjykime për krime të luftës si në organizimin e dosjeve mbi rastet e caktuara. Besojmë se kjo formë e zhvillimit shoqëror kishte me rrit në njëfarë forme veprimin e përgjithshëm që edhe dëshmitarët të jenë pak më akut, të drejtpërdrejtë dhe me u njoftuar pak më shumë. Kjo kishte mund t'i ndihmojë edhe komisionet ekzistuese zyrtare të cilat ekzistojnë nëpër këto vende për të pagjetur, me zbulimin e varrezave të fshehta masive dhe zgjedhjen e fatit të pagjeturve. Mund të krijojë mirëkuptim dhe tolerancë dhe t'u kthehet dinjiteti viktimave dhe familjeve të tyre. Në çfarë forme ose si mund të bëhen të gjitha këto? Nëse kemi një trup, domethënë sikur është ideja që të krijohet një komision rajonal i cili është i pavarur, i dalë apo i iniciuar prej këtyre familjeve, prej këtyre shoqatave dhe i krijuar në nivel rajonal në formën e pavarur prej ekspertëve të ndryshëm të lëmive të cilët e kanë besimin e këtyre njerëzve dhe bashkërisht pastaj këta të veprojnë, si një trup i cili është i themeluar në shtetet trashëgimtare të vendeve të ish-Jugosllavisë. Duhet të jetë një komision i cili është i pavarur nga themeluesit e vet. Kjo në njëfarë forme tregon se komisionet ose anëtarët e komisioneve duhet të zgjedhen nga vetë ata të cilët kanë besim këto familje, mirëpo gjithsesi duhet të shkohet në formën hierarkike përmes parlamenteve të vendeve të secilit prej këtyre shteteve. Një trup rajonal duhet të formohet, do të thotë trup rajonal i cili fokusohet në përvojat e viktimave. Trup i përkohshëm i themeluar për një periudhë të caktuar dhe i vendosur në territorin ku janë kryer krimet. Do me thënë kjo nuk mund të jetë... zakonisht kemi praktika nëpër vende, për këso lloj të komisioneve nuk është herë e parë që krijohen, do të thotë kemi shumë komisione të cilat krijohen nëpër botë mirëpo e veçanta e këtij komisioni është që në këtë rast përfshin më shumë shtete, i përfshin të gjitha vendet e dala nga ish-Jugosllavia dhe në njëfarë mase kërkohet që të gjitha këto, do të thotë, të kalojnë nëpër atë përvojën që e ka veçantinë e vet në territorin ku janë zhvilluar krimet. Nuk mund të jetë i barabartë me asnjë vend tjetër të botës, por në njëfarë mënyre të përdoret metodologji sikur në vendet tjera. Ky trup duhet të jetë trup jashtëgjyqësor, në mandatin e të cilit janë veprat më të rënda të kryera në periudhën e përcaktuar kohore. Mendohet

se me u marrë varësisht, është edhe një model me të cilin punohet, mendohet me u marrë me shumicën e krimeve të rënda së paku dhe për fatin e të pagjeturve, mirëpo duhet me u përcaktuar një kohë, ky trup duhet me pas një kohë me të periudhë kohore do të merret. Deri më tash ne e kemi përmendur se kryesisht dhe në bazë të të dhënave kryesisht dhe për këtë sigurisht se do të na tregojë edhe zonja Natasha Kandiç, është veprimi i saj që prej vitit 1991 e deri në vitin 2001 kur ka qenë ajo vala më e madhe e luftërave në këto vende të ish-Jugosllavisë. Ky trup jashtëgjyqësor në njëfarë forme është dashur të ketë edhe dëgjimet publike të viktimave. Prapë, ky trup jashtëgjyqësor i cili nxjerr përfundime lidhur me faktet, me atë se çka ka ndodhur në bazë të hetimeve të veta dhe fakteve të vërtetuara gjyqësore, por nuk nxjerr konkluzione juridike.

Trup hartues i cili ka autorizime të intervistojë secilin që ofron informata relevante, të zbatojë hetime multidisiplinore, të ftojë individët në të njëjtën cilësi si dhe përgjegjësit e institucioneve, grupeve politike dhe bashkësive fare që të japin të dhëna dhe të paraqesin mendimin e vet mbi tejkalimin e kësaj gjendjeje. Ky komision mund të jetë një trup hetues i cili mund të sigurojë prova mbi atë se çfarë mënyre institucionet e caktuara individët apo grupet nuk kanë mund të mbrohen dhe të sigurojnë të drejtat e njeriut në të kaluarën. Trup i sigurt i cili do të merr parasysh vetëm theksimet mbi krimet e luftës dhe të cilat janë vërtetuar të paktën nga dy burime. Domethënë ideja është që ai rasti i caktuar të jetë i konfirmuar së paku nga dy burime faktike.

Trup i cili askënd nuk e gjykon. Domethënë nuk është një gjykatore, por mund t'i emërojë kryerësit dhe përgjegjësit për veprat e rënda, si dhe të rekomandojë mekanizmat për largimin nga institucionet që ndoshta akoma vazhdojnë ata si njerëz. Trup hetues i cili në bashkëpunim me komisionet zyrtare që kryesisht janë nëpër këto vende për personat e pagjetur të zbatojë hetime mbi fatin e të zhdukurve dhe dhunën. Trup i cili harton rekomandime në drejtim të programit të reparacionit për viktimat në formën e kompensimit material, kërkimfaljeje, ndërtimin e përmendoreve, të qendrave përkujtimore, hartave të kujtimit. Domethënë në njëfarë forme përcakton një lloj politike të veprimit edhe në raport me dëmshpërblimin ndaj viktimave, nëse shihet se është e mundshme, në raport me kërkimfalje ndaj subjekteve të ndryshme, në mes atyre që kanë qenë në konflikt, ndërtimin e përmendoreve. Edhe një herë po e ceku se është ndër pikat goxha interesante që këto gjëra me mbet gjatë tërë kohës në kujtim dhe me mësuar në një formë prej asaj çka ka ndodhur dhe në njëfarë forme mos të lihet hapësirë që në të ardhmen të përsëriten prapë.

Trup kredibil, të cilin e përbëjnë individë të shquar në vendet e tyre dhe në rajon, përfaqësuesit e grupeve të ndryshme etike, të bashkësive religjioze, të emëruarit dhe të zgjedhurit në bazë të kriterëve të shkruara saktësisht. Do të thotë, ideja është që këta njerëz që kanë me përbë komisionin në nivel rajonal të jenë njerëz kredibil për pjesët e popullatës nga të cilët vijnë dhe me pas zërin e plotfuqishëm dhe një saktësi, do të thotë mos me pas përzjerje politike por me qen një aspekt profesional i veprimit të këtyre grupeve. Kjo është, do të thotë, ajo hyrja e parë e asaj se çka tentohet dhe pse ky komision. Sigurisht se në pika në vazhdim do t'i theksojmë pak më thellësisht dhe t'i hyjmë më thellësisht detajeve tjera. Kjo është tash për tash prej anës sime.

Bekim Blakaj: Faleminderit shumë Veton! Vetoni në një moment e përmendi se ka pasur shumë komisione të ngjashme nëpër botë, do të thotë ku ka pas luftëra, pastaj janë krijuar. Koalicioni ynë, i organizatave joqeveritare që e shtynë idenë e themelimit të komisionit rajonal është

shërbyer shumë me përvojat e këtyre komisioneve dhe kemi tentuar që të mësojmë se ku kanë pasur lëshime, ku kanë bë gabime e kështu me radhë, dhe një ndër to është se pse ne e konsultojmë shoqërinë e gjerë, edhe shoqërinë civile dhe institucionet e ndryshme dhe bashkësitë fetare, është sepse kemi vërejtur se aty kur nuk është konsultuar shoqëria civile puna e komisionit nuk ka qenë e pranuar nga ana e shoqërisë civile.

Sidoqoftë ne sot për juve kemi zgjedhur një insert të një filmi dokumentar dhe që ka të bëjë me komisionin i cili është krijuar në Maroko. Mirëpo, edhe pse nuk kemi mund ta errësojmë mirë sallën, shpresoj se megjithatë do të mund ta ndjekim filmin dokumentar.

(Filmi dokumentar)

Bekim Blakaj: E patë se sa me rëndësi janë seancat e ashtuquajtura dëgjime publike të filmuara. Edhe pas shumë zhvillimeve. Andaj, do ta kisha lutur zonjën Natasha Kandiç të na tregojë më detajisht lidhur me rrjedhën e procesit konsultativ deri më tani për KOMRA-n dhe me këtë edhe e përfundojmë pjesën informative e pastaj do të vazhdojmë pas pauzës me debate dhe paraparakisht me një ligjërim të shkurtër të profesorit të nderuar Ismajl Hasani. Urdhëroni, zonja Kandiç!

Nataša Kandić: Kërkoj ndjesë sepse filmi nuk mund të shihet siç kishte deshtë të shihet për shkak të dritës, por ne kemi menduar që kishte qenë e rrugës për ta shikuar edhe në këto kushte. Siç tha Bekimi, qëllimi ynë me këtë film është për të treguar fuqinë e dëgjimit publik të atyre që janë viktimat dhe gjithashtu për të parë se cili është roli i anëtarëve të komisionit. Keni vërejtur se si një grua, anëtare e Komisionit thotë se është detyrë e tyre për të treguar solidaritet, bashkëndjenje, dhe për të demonstruar sigurinë e viktimave që këto viktimat janë të rëndësishme për ta. Kjo është ajo që është problem në rajon, në këtë pjesë të Ballkanit. Nuk ka asnjë solidaritet me viktimat, nuk ka klimë të bashkëndjenje për viktimat, viktimat përmenden vetëm në ditë të caktuara, kur bëhen përkujtimet për krimet e rënda, pas cilës viktimat harrohen. Anëtarja e komisionit theksoi se sa e rëndësishme është që të tregojmë viktimave që ato janë të rëndësishme për shkak të së kaluarës por edhe të ardhmes. Në qoftë se në këtë rajon nuk do të ketë fuqi për të rishikuar kaluarën të bazuar në fakte, për të treguar respekt për viktimat, të bazuar në fakte, kam frikë se nuk ka dalje, nuk ka dyer të tilla të hapura. Ju përkujtoj fjalët e gruas randomë e cila thotë ju falënderoj për këtë derë të hapur. Mendoj se e tërë kjo iniciativë e jona për formimin e Komisionit Rajonal është ajo derë e hapur, e cila duhet shumë mirë për të rishikuar kaluarën, atë që ka ndodhur, por duhet të jenë të hapura kah e ardhmja, që do të thotë të mendohet në brezat të ardhshëm, natyrisht të rinj në këtë moment, por edhe në brezat e ardhshëm. Kjo derë e hapur ka një kuptim, mund të kontribuon në marrëdhënie të reja për të ardhmen dhe për të kaluarën vetëm nëse janë të bazuara në fakte, respekt ndaj viktimave dhe një klimë të re në rajon e ajo është klima e solidaritetit dhe klima në të cilën në fakt dominon fryma politike dhe shoqërore e kjo është nevoja për të arritur deri tek një normalizimi i marrëdhënieve dhe që politikanët besojnë se janë krijuar kushtet për jetë normale, për një qëllim të madh. Vetëm në këto rrethana ne në këtë pjesë të Ballkanit, kemi një gjasë për të ardhmen. Kjo ide e organizatave jo-qeveritare nuk ka asnjë gjasë për të qenë e suksesshme në qoftë se nuk bëhet një projekt shtetëror. Për të qenë një projekt shtetëror roli i komuniteteve fetare është shumë, shumë i rëndësishëm. Roli viktimës dhe angazhimi i tyre është gjithashtu shumë i rëndësishëm. Por të përfituar një numër të madh, të gjerë të popullsisë është gjithashtu një kusht për tu bërë një projekt shtetëror. Ajo nuk është gjë e vogël për të krijuar një koalicion rajonal – asociacioni i organizatave cilat me vite nuk kishin

komunikim. Nuk është lehtë të bashkohen shoqatat e viktimave - viktimave shqiptare, shoqatat e viktimat, të viktimave serbe, nuk është lehtë të bashkohen të gjitha shoqatat e viktimave nga e gjithë rajoni i ish-Jugosllavisë. Por, shoqëria civile ka pasur sukses. Ne e bëmë këtë. Kjo është një hap i madh, hap i madh pranë jetës formale politike. Ju shihni se normalizimi i marrëdhënieve politike është duke shkuar shumë, shumë ngadalë, por gjithmonë në historinë e atyre shoqërive që kanë pasur luftëra, gjithmonë ekziston një hapë i mirë civil dhe pastaj nën presion organizatave civile, institucionet dhe shtetet ngadalë ndryshojnë qëndrimet e tyre ndaj vlerave dhe pas nevojës për një të ardhme demokratike. Ish-Jugosllavia dhe ajo çka ka ndodhur në këtë rajon është një rast unik. Nuk ka ndonjë shembull në botë që ka pasur ndonjë luftë rajonale dhe që viktimat ishin shpërndarë, që sot është e vështirë për të arritur deri tek kryesi i krimit, është lehtë për t'i shmangur drejtësisë, por kjo tregon se dhe në qoftë se vije deri tek përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet vendeve, ndërmjet shoqërive, ndërmjet grupeve civile ngadalë krijohet një klimë në të cilën mund të ketë më shumë gjasa për të krijuar një jetë të pranueshme shoqërisë sociale në të cilin do të ketë respekt për viktimat, dhe me zërë më pak armiqësor dhe akuza. Kemi nevojë për një kohë konstruktive, kemi nevojë të mendojmë se na duhet një ardhme në të cilën nuk do të ketë vrasje, në të cilën nuk do të ketë grabitje për arsye etnike, gjithmonë do të ketë krime, me më pak krime jeta e individëve do të ishte më i mirë, por pas luftës, dhe kjo është diçka që ne mësojmë nga përvoja e të tjerëve, gjithmonë rritet krimi dhe kjo kërkon politikanët të cilët kanë për qëllim të krijojnë një shoqëri në të cilën individët, sidomos ata që kanë vuajtur në të kaluarën do të kanë më mirë. Cilat janë gjasat tona? Gjasat ekzistojnë, sepse është një nevojë e madhe për të. Paramendoni, në Kroaci është tani 19 vjet që nga luftëra, në Bosnjë e Hercegovinë 15 vjet, në Kosovë 11 vitet nga krimet e bëra. Ne ende kemi në mes të 16 dhe 17 mijë të atyre fati i të cilëve është i panjohur, kufomat e të cilëve apo mbetjet mortore ende nuk janë gjetur. Jetën e familjeve që janë ende në kërkim të eshtrave të dashurve të tyre është e vështirë të përshkruhet, por duhet të pranojmë, që shumë pak flitet rreth kësaj apo që ka shumë pak solidaritet, kudo në Kosovë, në Serbi, Kroaci, Mal të Zi. Maqedonia, ka shumë pak solidaritet. Ne kemi nevojë në njëfarë mënyre për të gjetur instrumente se si banorët e territorit të ish-Jugosllavisë të përfitojmë rreth kësaj temë. Të gjithë pajtohen se është mjaftë përfolur rreth luftës. Sot është mjaft më për të folur në lidhje me viktimat. Të gjithë dëshirojnë një jetë më të mirë. Politikanët flasin për luftë dhe krimet e luftës kur vijnë zgjedhjet, pastaj vije koha kur familja e viktimës është braktisur dhe më vetë vetën. Nuk është lehtë për ti përfituar, por ne kemi nevojë për shumë miliona njerëz ti përfitojmë në këtë iniciativë. Jemi duke llogaritur në bashkësitë fetare, në kishat dhe tek komuniteti serb, Kisha Katolike, Ortodokse, Adventistë, bashkësitë Hebrenj që mund shumë për të na ndihmuar, roli i tyre në procesin e pajtimit, apo ta quajmë normalizimit të jetës, krijimi i solidaritetit, klimës, dhembshuri mundet shumë për të ndihmuar. Ne për herë të parë kemi filluar konsultimet me komunitetin fetare në Kroaci. Vitin e kaluar, në Zagreb dhe Osijek, ne kemi organizuar një debat të tillë informative dhe shumë na ka ndihmuar një peshkop nga Afrika e Jugut. Ai ishte dëshmitar para Komisionit - Komisionit të Afrikës së Jugut. Ky është një njeri i cili e kupton atë, pra ky është njeriu i Perëndisë i cili e kupton rëndësinë e pajtimit, por gjithashtu është njeriu i cili pretendon respektin për viktimat dhe për të treguar nderimin ndaj viktimave. Pas Kroacisë, kemi parë dhe natyrisht në kanë ndihmuar shumë dhe Franjevci, të cilët kanë mirëkuptim shumë të madh dhe një nevojë të fortë për t'u përfshirë në këtë proces, të cilat na ndihmuan për të krijuar që dhe konsultimet në Serbi me datën 16 Qershor të jetë shumë konstruktive dhe shumë të mira. Shumicës ju kemi postuar komentet nga këto konsultime, sugjerimet dhe mendimet nga konsultimet në Serbi nga të cilat ju mund të shihni se sa shumë ekzistonin gjera të përbashkëta në mesin e të gjithë këto të ndryshme komunitete fetare, siç ekziston marrëveshje duke filluar nga komuniteti hebrej, për tu dakorduar

komuniteti fetar duke mbështetur këtë nismë për të ndihmuar që të bëhet një projekt shtetëror. Sigurisht, që ka pasur pyetje a ka vullnet politik të mjaftueshëm për të arritur deri tek kjo. Ka pasur pyetje – A nuk janë të mjaftueshëm gjykimet për krime të luftës? Pastaj kemi biseduar për atë dhe kemi argumentuar se gjykimet për krime të luftës janë të rëndësishme, vendimet të gjykatës dhe fakte ligjore, por këto shumë pak arrin deri tek opinioni. Këto fakte ligjore do të jenë objekt i hulumtimeve të historianëve, sociologëve, avokatëve, politologëve, por ne kemi nevojë për diçka më shumë se sa përqendrimi në të akuzuarit. E dini, roli i viktimave në gjykime për krime të luftës janë shumë të kufizuara dhe gjykata ata i fton për të vërtetuar fajësinë e të akuzuarve. Gjykata ka të drejtë të ndërpresë çdo viktimë, dhe viktimën e krimit më të tmerrshëm, sepse gjykata e ka procedurën e vet, çështjet të cilat janë shumë të rëndësishme për gjykatën për të vërtetuar përgjegjësinë e të akuzuarve. Do të thotë, ndërprerja është e lejuar me ligj të gjyqit çka mund të shqetëson viktimat dhe dëshmitarët dhe ti sjellë në një situatë të pyesin - Çfarë është kjo drejtësi? Ne kemi nevojë, përveç këtyre gjykimeve, pikërisht atë që kemi parë në këtë film, e ajo është që viktimat flasin pa u penguar, tërë ky rajon, shoqëri të krijuara, shtetet e krijuar në territorin e ish-Jugosllavi të jenë në gjendje për të dëgjuar viktimat nga të gjitha ato luftëra, që ne mund të krijojmë një sistem të ri vlerësimi të respektit për viktimat dhe që në bazë të fakteve e dimë se çfarë ka ndodhur. Ky është shanci ynë i vetëm për dalje dhe për ballafaqim më të kaluarën që do të sjellë dëmshpërblim. Gjëra të tmerrshme kanë ndodhur, por ne duhet të gjejmë mënyrë për të trajtuar këtë trashëgimi të vështirë. Ne nuk duhet të harrojmë, ky komision duhet të na shërbejë për të mos harruar, të gjithë të përkujtomë çfarë ka ndodhur. Faktet lehtë do të tregojnë se çfarë ka ndodhur. Ne duhet të dimë emrat e atyre viktimave, duhet ti dimë, duhet për të dëgjuar zërin e atyre që sot mund të na tregojnë dhe vazhdimisht të kemi parasysh se ne jemi të obliguar për brezat e ardhshëm, të obliguar historikisht për të mësuar secili nga fusha e profesionit të vetë, nga këndi i komunitetit të cilit i takon, dhe më në fund nga perspektiva e asaj që ne jemi të gjithë pjesëtarët të komunitetit njerëzor për të parandaluar që disa njerëzve në të ardhmen ju ndodhe ajo çka ka ndodhë duke filluar, të themi nga viti 91, kanë ndodhë gjëra të tmerrshme dhe përpara, por jemi nisur nga ajo se në qoftë se jemi duke folur për krime lufte, atëherë ne duhet të respektojnë standardet të drejtës ndërkombëtare e cila thotë se që nga ajo periudhë kanë ndodhur krime lufte. Ne kemi thonë, por ajo është ende në diskutim, se mandati duhet të jetë deri në fund të vitit 2001, sepse në atë kohë kanë ndodhur krime të rënda, në lidhje me luftën dhe konfliktin e armatosur. Megjithatë, në debate të deritanishme kemi pasur rreth 100 debate në të gjitha shoqëritë e ish-Jugosllavisë, duke përfshirë 3 Korrikun debatin e mbajtur në Maqedoni, që dhe pas kësaj periudhe kohore kanë ndodhur, vrasjet, zhdukjet, të cilat kanë përfunduar me vdekje në lidhje me atë luftë. Detyra e Komisionit do të jetë për të hetuar të gjitha këto raste dhe se emrat e këtyre viktimave nuk të harrohen, që emrat dhe pësimi i tyre janë pjesë e regjistrit të viktimave, viktimave civile dhe ushtarake, natyrisht, sepse është e rëndësishme që të kemi këtë bilanc të humburve, humbja e njeriut në çdo shoqëri. Ne sot nuk do të flasim këtu për draft statutin e komisionit, sepse kemi menduar se në takimin e parë siç është ky tani, ndoshta është një detyrë shumë e madhe, por për draft statut, objektivi ynë është për ta bërë deri me 10. Dhjetor vitit 2010 në këto debate ja japin një formë në tërësi për të prezantuar me 10 Dhjetor, në ditën e drejtave të njeriut, në ditën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në Sarajevë, të bëjmë prezantimin e statutit të komisionit rajonal të bashkangjitur me një milion nënshkrime të mbështetjes, që atëherë në mars, prill dhe maj organizojmë një fushatë për të mbledhur një milion nënshkrime dhe pastaj me datën 1. Qershor 2011 i dorëzojmë parlamenteve në territorin e ish Jugosllavie me statutin e komisioneve rajonal me mbështetjen e një milion nënshkrime. Deri atëherë, ne duhet të zgjedhim disa çështje për të cilat ende sot debatohet. Deri tani, e kemi mbështetjen e Bashkimit Evropian, por kjo nuk është më e rëndësishme. Ne kemi nevojë për të

marrë mbështetjen e opinionit në të gjitha shoqëritë, në të gjitha vendet e territorit të ish-Jugosllavie. Ne tani fillojmë me fushatën e cila do të përbëhet nga inicimi i kësaj iniciative në opozitë politikanëve. Me datën 30. Gusht vitit 2010. ne kemi një takim me Presidentin kroat Ivo Josipović, ne do të kërkojmë dhe takim me Presidentin e Serbisë. Dy javë më parë në Kuvendin e Malit të Zi i organizuar nga Parlamenti i Malit të Zi, janë zhvilluar bisedimet. Pra, ky është reagimi i parë zyrtar të Parlamentit malazez cili mbështeti nismën për krijimin e një komisioni rajonal për verifikimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe viktimave. Kjo është një nxitje shumë e madhe, por të gjithë thonë - kjo është më e lehtë për tu bërë në Malin e Zi se sa në shoqëri tjera. Tani do të përballemi me një hap të madh, me politikanët. Presim që të kemi përkrahjen e bashkësive fetare dhe sot keni mundësi që ju të na tregoni se si e shihni procesin e pajtimit, apo atë që ne e quajmë ne këto diskutimet tona – procesi i krijimit një klime, bashkëndjenje, solidariteti dhe respekti. Pas pauzës dhe pas paraqitjes së Profesor Hasanit, ajo do të jetë koha e juaj, fjalët e juaja, çfarë është mendimi juaj cili është shumë e rëndësishme për ne dhe ju lutem mbani në mendje se ne kemi nevojë për një fjalë konstruktive, mbështetje në një mënyrë pozitive si dhe shumë sugjerime dhe këshilla te cilat në këtë kohë kur ka shumë të papajtueshmëri, se si bashkësitë fetare mund të na ndihmojnë për të arritur deri tek ky qëllim dhe për të ndihmuar në marrjen e mbështetjes për këtë iniciativë. Mirë, unë fola ma shumë se tri minuta, e tejkaloja kohen e lejuar, kërkoj falje për këtë!

Bekim Blakaj: Falmenderit shumë Nataša!

Tani ju ftoj në një pauzë për kafe, shpresoj se stafi i hotelit do të na mundësojë kush do edhe jashtë mund të pi kafe, ndoshta pa i qit ato tendat. Faleminderit!

(Pas pauze)

Bekim Blakaj: Po fillojmë me sesionin e dytë të konsultimeve. Shpresoj se jeni freskuar sado pak me kafe. Tani po e lus profesorin Ismajl Hasani i cili do të na flet më shumë për rolin e bashkësive fetare në procesin e pajtimit. Profesor, urdhëroni!

Ismajl Hasani: Falënderoj kryesuesin! Është normale se kur njeriu gjendet para një nisme të tillë, të një projekti grandioz i cili për koordinatat e Evropës Juglindore ka kuptim edhe për rrugën e mëtejme të integritetit të këtij rajoni në Bashkimin Evropian, në mënyrë të veçantë kur në ballë të këtij projekti ose të kësaj ndërmarrjeje është e involvuar zonja Kandiç, e cila me shembullin e vet të luftës pa kompromis për gjetjen dhe identifikimin e asaj që ka ndodhur në territorin e ish-Jugosllavisë ka treguar në mënyrën më të saktë shembullin se si është e mundur që njeriu për idealet e veta, për synimet e veta për ta treguar deri në fund sensin e humanitetit, mund të bëjë dhe të krijojë situata të cilat për etnitetin e vet, për pjesën etnocentrike të etnitetit të vet në disa raste nuk janë edhe të këndshme. E them, jo rastësisht, dhe përmend zonjën Natasha Kandiç, jo rastësisht në këtë takim, që është iniciativ për projektin, kur kam parasysh disa prej miqve të mi, të cilët personalisht i njoh, që janë pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme fetare dhe të tjerët të cilët duhet të jenë të vetëdijshëm për rolin që kanë bashkësitë fetare në përgjithësi, në këtë rast në mënyrë të veçantë në Kosovë për të mbështetur nismën e KOMRA-s që ka kuptimin e tregimit të humanizmit në pjesën e Evropës Juglindore. Duke qenë i shkëputur për disa vite, duke i jetuar në

një vend në të cilin kisha protestante i përmbahet parullës “Bi making èith out bi longing” që do të thotë të gjithë njerëzit, të gjithë norvegjezët janë pjesëtarë të kishës protestante norvegjeze, pa marrë parasysh anëtarësimin, pa marrë parasysh shkallën e religjiozitetit, e tjera, e tjera. Kosova, si shoqëri multietnike dhe multireligjioze dhe i gjithë rajoni i Evropës Juglindore duke përmbajtur këto veti është shumë e rëndësishme që udhëheqësit fetarë, reprezentët e bashkësive të ndryshme fetare por edhe njerëzit e komuniteteve fetare të cilat fatkeqësisht edhe më tutje nuk kanë legalitetin në shoqëritë në tranzicion siç është Kosova, është shumë e natyrshme që këta njerëz në këtë proces do të duhej të jenë ndër t parët. Unë nuk dua të futem në histori, në atë se çka komunitetet fetare në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë bashkësitë fetare të të gjitha përkatësive konfesionale në Kosovë bartin si përgjegjësi ose janë përgjegjës para historisë jo për të bëmat por për neglizhencën dhe sjelljen në disa situata ndoshta edhe të papërgjegjshme për atë se çka ka ndodhur në territoret e ish-Jugosllavisë. Historia e Evropës Juglindore njeh njerëz edhe të vetëflijimit edhe të vetësakrificës, siç e kemi për shembull në shqiptarët përkatësisht kisha katolike shqiptare, siç ka personin e Gonxhe Bojaxhiut ose Nënë Terezës. Por, mbase studiuesit, teologët dhe njerëzit tjerë të cilët janë në mënyrë të drejtpërdrejtë të përfshirë në veprimtarinë fetare sfidojnë veten kur përpiqen të më përgjigjen mua, për shembull, se a kemi ndonjë personalitet brendapërbrenda bashkësive fetare, jo vetëm në Kosovë por në gjithë territorin e ish-Jugosllavisë, përjashtoj disa raste, që është vu në ballë të mbrojtjes së të drejtave elementare të njeriut. Të mos flasim që ta përdorë personin e vet, autoritetin e vet, moralin e vet, ndjenjat e veta si baritor, t’i përdor deri në skajshmëri për t’u vu në mbrojtje të dinjitetit përkatësisht të drejtave elementare të njeriut për të shpëtuar jetërat. Kjo nuk ka ndodhur shumë, ka vetëm disa raste, po kjo nuk do të thotë se kërret fetarë në përgjithësi kanë barrë të rëndë në situatën që ne po kalojmë për momentin, të mos flas për projektin grandioz i cili, edhe një herë po them, i jep kuptimin Evropës Juglindore si vend human, si vend në të cilin me përgjegjësi të plotë njerëzit ballafaqohen me realitetin. Unë do të doja që paralelisht me fëmijun e viktimës që ka përfunduar si fatkeq, si i kthyer në Kosovë, sot në këtë nismë të kisha para veti ose të kishim para veti këtu edhe tjetrin ose tjetrën që ka përjetuar tmerret e luftës në Kosovë - jetimin ose fëmijun që ka përjetuar përgjakjen e prindërve të vetë, ose i është vrarë babai ose nëna e tjera, e tjera. Kush i sjell këta njerëz para veti dhe kush i qet këta njerëz para nesh? Unë mendoj se pyetja e parë, që njeriu bën në jetën e vet dhe e fundit, është pyetja kush jam unë në aspektin e përkatësisë shpirtërore? Çështja e religjionit, përkatësisht e përkatësisë fetare është pyetja e parë që fëmija i bën vetës sapo ndërjegjësohet për veten dhe pyetja e fundit, para se të përfundojë këtë jetë. Në këtë kuptim, unë konsideroj se shembujt që i kemi gjithandej globit tokësor dhe në mënyrë të veçantë kërret fetarë në Afrikën e Jugut do të duhej të shërbejnë si model për njerëzit që janë prezentë të bashkësive fetare në Kosovë dhe në rajon që të mos jenë vetëm pjesëtarë të nismave të ndryshme siç është takimi i sotëm që flasim dhe mbështesim një ndërmarrje e cila ka kuptim për njerëzimin jo vetëm për Ballkanin, siç është projekti i KOMRA-s. Por, në të njëjtën kohë, me kthimin në do të krijonim mundësi që bashkësitë fetare të fuqizohen në shoqërinë demokratike. Ne kemi rrafshin e integriteteve popullore si komunitete etnike dhe komunitete fetare, i cili na funksionon për mrekulli. Ka studiues të ndryshëm të cilët të njëanshëm të cilët Ballkanin e konsiderojnë si arenë e përgjakur dhe përplasjeve historike. Dhe në këtë kontekst, serbët dhe

shqiptarët vazhdimisht përpiqen që t'i paraqesin si komunitete etnike, etnitete etnike dhe entitete fetare të përplasjeve të vazhdueshme historike. Kjo nuk qëndron, të nderuar! Historia flet për përplasje, përleshje dhe luftëra episodike jo vetëm midis shqiptarëve dhe serbëve por edhe të tjerëve në këto koordinata. Por jo vetëm këto situata. Është mirë që udhëheqësit e bashkësive fetare pra se gjithash t'i pastrojnë punët brendapërbrenda vetit, të krijojnë klimën e harmonisë edhe përkujdesjes ndaj besimtarëve të vetë, duke siguruar liri totale fetare për të gjithë njerëzit, jo ekstremizmi, jo paraqitje dhe surrogate të besimtarëve, që është hapi i parë për të fituar të drejtën t'i shkosh komunitetit tjetër fetar dhe të kërkosh dorën e aktivitetit për nismën që ka para vetit KOMRA. Çka dua të them me këtë? Në përmasa botërore ideja e komunizmit gjallon ose e ripajtimit midis përkatësive të ndryshme konfesionale. Por, ideja e komunizmit në miniaturë brendapërbrenda komuniteteve fetare duhet të jetë moto e secilës bashkësi fetare në Kosovë. Ka situata të ndryshme në të cilat njerëzit gjenden pa dashjen e tyre ndjehen keq kur përmes majorizimit ose në rastin ekstrem tjetër përmes dhënies së favoreve komuniteteve të vogla fetare – të diskriminimit pozitiv, i bëhet dëm komunitetit të caktuar fetar. Që të dy këto qasje janë të gabueshme për mbarëvajtje të jetës religjioze. Jo vetëm në Kosovë, por edhe në përmasa tjera. Atëherë kur komunitetet fetare, sepse jemi dëshmitarë që viteve të fundit ka një shpërputhje të aktiviteteve brendapërbrenda komuniteteve fetare, ka një kontaminim të ambientit brendapërbrenda vetë komuniteteve të ndryshme fetare. Marr parasysh, për shembull situatën jo shumë të largët, brendapërbrenda kishës ortodokse serbe, ose marr parasysh lëvizjet e ndryshme, trendet e ndryshme të pafavorshme për kontekstin aktual që po jetojmë, brendapërbrenda bashkësisë fetare islame në Kosovë, ose komuniteteve tjera fetare në Kosovë. Në momentin kur bashkësitë fetare qoftë ato zyrtare të cilat në një mënyrë ose tjetër kanë bekimin e qeverisë, por edhe komunitetet fetare të cilat gjallojnë, ekzistojnë dhe dëshirojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre me besimtarët e tyre, të konsolidohen, jo vetëm në pikëpamje shpirtërore se ata nuk e kanë problem ekzistimin brendapërbrenda vetes. Ata e kanë problem identifikimin e vetes me këtë kontekstin e përgjithshëm shoqëror, të cilin shoqëria nuk e kupton nganjëherë, që për të mos thënë, edhe i përbuzë. Atëherë unë konsideroj se komunitetet fetare do të mund të jenë krah i fortë i këtij projekti grandioz për të cilin do të duhej jo vetëm përcaktim plebicitar në Evropën Juglindore. Unë nuk e konsideroj që vëhet në pyetje një milion nënshkrime për atë që është motoja e KOMRA-s por konsideroj se në Evropën Juglindore përkatësisht në ish-Jugosllavisë ka njerëz të lodhur, jo vetëm nga skenat e luftës, jo vetëm nga vrasjet e përdhunimet, nganjëherë edhe nga bekimet e komuniteteve fetare që iu kanë dhënë këtyre përdhunimeve, por ka lodhje të njerëzve me paraqitje frazeologjike në disa raste të komuniteteve fetare karshi jo vetëm asaj që ka ndodhur por karshi edhe perspektivës së ardhshme për zhvillimin e Evropës Juglindore. Unë mendoj se në procesin e rikoncilimit si ide ka pasur një nismë menjëherë pas luftës në Kosovë, një nismë e cila nuk është kuptuar drejt dhe pa fajin e askujt përjashtoj përgjegjësinë e qeverisë së përkohshme atëherë, sepse unë kam qenë i involvuar në këto procese menjëherë pas luftës, përjashtoj qeverinë e përkohshme që s'ka qenë e gatshme ta mbështesë deri në fund këtë ide, ajo ka mbetur në gjysmë të rrugës. Tani kur kemi një situatë tjetër dhe tani po përpiqem që të identifikohem me pjesën e përfaqësuesve ose reprezentëve të komuniteteve fetare që janë këtu. Është shansi jetik i të gjitha komuniteteve fetare që jo vetëm në mënyrë deklarative ta mbështesin

idenë e KOMRA-s por është shansi i vetëm, kushtimisht po e them, edhe për ta shfajësuar veten për atë që është neglizhuar deri më sot. Nuk kanë zgjatur shumë vite në asnjë vend ku ka pas konflikte. Ne e pamë storien e Marokos, nuk ka zgjatur shumë vite kur baritorët, përgjegjësit ose udhëheqësit shpirtëror të komuniteteve fetare edhe me sjellje personale kanë qenë iniciatorë të përpjekjeve për rikoncilim ose për pajtim. Unë them se nuk është momenti që të akuzojmë njerëzit por është momenti që të veprohet dhe ata që e quajnë veten udhëheqës shpirtëror i një komuniteti të caktuar fetar e që identifikohen edhe me komunitetin në aspektin organizativ por edhe shpirtëror është mirë që të jenë iniciatorë edhe të nismave të cilat do të jenë sigurisht edhe pararendëse ose mbështetëse të idesë së KOMRA-s. Këta njerëz që funksionojnë brenda këtij mekanizmi, nuk kanë vetëm nevoja për mbështetje tavolinash, por në meshat e ndryshme, me rastin e aktit të faljeve të ndryshme, festat e ndryshme të shenjta të cilat i kanë komunitetet e ndryshme fetare është mirë që të shfrytëzohen takimet e ndryshme, formale, jo formale, në kishë, në xhami, në institucione të objekteve tjera të kultit e tjera, e tjera, që të bisedohet, të bisedohet, të sensibilizohet opinioni, të kemi një përgatitje sepse siç u vu në diskutim edhe këtu nga pararendësit që folën Gjykata e Hagës bën punën e vet. Por, popujt të cilët në një mënyrë ose tjetër kanë qenë të involvuar në tmerret që ka përjetuar Evropa Juglindore përkatësisht Ballkani kanë përgjegjësi historike për ta shfajësuar veten. Dhe, nuk është në natyrën e komuniteteve fetare që të dalin publikisht dhe të kërkojnë falje në emër të popullit. Kisha Katolike e Romës nuk ka pasur nevojë asnjëherë as me enciklika, as të dalë publikisht e të kërkojë falje për luftën e kryqëzatave. Por Kisha Katolike e Romës përmes mesazheve të ndryshme, përmes enciklikave, përmes porosive të ndryshme të urta, ka bërë veprime të veta vazhdimisht duke bërë përpjekje që luftën e kryqëzatave ta postojë diku larg historisë, si diçka që njerëzimit i ka ndodhë si fatkeqësi. Kërkim-faljen e kanë për detyrim ta bëjnë politikat. Kërkim-faljen publike! Ata e kanë për detyrim, sepse në instancën e fundit ata kanë qenë edhe aktorët kryesorë të këtyre fatkeqësive që popujve iu ka ndodhur në Evropën Juglindore. Detyra e shërbyesit të zotit, detyra e njeriut që është reperzent i përkatësisë së caktuar fetare, është porosia e urtë, është paraqitja me dinjitet para besimtarëve dhe vazhdimisht ikja e situatave të ndryshme konfliktuoze sidomos kur kemi situata qesharake kur edhe më tutje, fatkeqësisht, në disa raste ndjejmë ose dëgjojmë kur njerëzit shqiptojnë, flas për krerët fetarë, shqiptojnë fjalë të cilat fyejnë dinjitetin qoftë etnik, qoftë fetar, qoftë njerëzor të njerëzve në Evropën Juglindore.

Ta zëmë, do të duhej përjashtuar detyrimisht nga fjalori i Kishës Ortodokse Serbe, termi “Kosovo i Metohija”. Nuk i bën nder Kishës Ortodokse termi “Kosovo i Metohija”. Nuk i bën nder Bashkësisë Fetare Islame të pafetë për pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme fetare. Dua të jem i hapur deri në fund, siç nuk i bën nder për shembull përplasjet e ndryshme që për mungesë kompetence profesionale, sepse jo të gjithë, prijësit e komuniteteve të ndryshme fetare kanë ekspertizë edhe profesionale. Ata mund të jenë besimtarë të devotshëm, por ata prijës fetarë që nuk e njohin deri në fund doktrinën fetare, jo vetëm të veten, por të gjitha doktrinat fetare brenda një shoqërie multietnike mund ta gabojnë shpirtin e vet si besimtar, të mos flas se mund të gabohen shumë rëndë edhe si baritorë, ose si udhëheqës shpirtëror. Unë dua t’i kthehem edhe një herë idesë së KOMRA-s sepse sot ne jemi këtu që përmes këtij diskutimi prej të cilit pres edhe propozime konkrete sigurisht prej pjesëmarrësve, ata që konsiderohen si akterë kryesorë, të

përpiqemi të reflektojmë për peshën e kësaj nisme, ndërsa bashkësive fetare t'u bëj ftesë, reprezentëve të bashkësive fetare t'u bëj ftesë që të mos e humbin shansin e fundit që të tregojnë se në Ballkan, në këto koordinata të Evropës ka njerëz që dinë, duan dhe mund të reflektojnë si genie humane, të përballen me realitetin, të përballen me atë që ka ndodhur dhe të mos e marrin viktimën e luftërave që ndodhën njëzet vjet e këtej vetëm për ta përfaqësuar për nevojat e veta utilitare që kanë me rastin e festave të ndryshme, kremtimeve të ndryshme, por të jetojnë me viktimën duke e mbështetur por edhe duke e ekspozuar viktimën hapur. Sepse, përderisa ne fshehim prapa perdeve viktimën, nuk mund të pretendojmë që jemi komunitet qoftë fetar, qoftë njerëzor që meritojmë një të ardhme të dinjitetshme, siç duhet të jetë sjellja e viktimës shumë e dinjitetshme, sepse nuk ka mundësi që në pafundësi në këto koordinata të jemi gjithmonë me vajë në buzë, si thuhet, dhe të themi – shiko çka na ka ndodhur! Njerëzve iu ka ndodhur tragjedi e tragjedi, të komuniteteve të ndryshme i janë hedhur me dhjetëra mijëra njerëz në det. Imagjino situatën e luftës Gjermani-Norvegji! Njerëzit kanë memorialet. Unë kam qenë mysafir i Parlamentit Norvegjez dhe në hyrje të detyrueshme të deputetëve të Parlamentit Norvegjez është libri i artë, në të cilin janë të shkruara – skalitura emra të 10.000 viktimave që kanë përfunduar në det gjatë luftës me gjermanët. Deputeti i Parlamentit Norvegjez paraprakisht duhet të kalojë kah ata emra që janë skalitur aty, para se të hyjë të marrë vendim për të ardhmen e vendit të tij. Por, të jeni të bindur, se norvegjezët nuk kanë prirje, nuk janë shumë vajtues siç jemi ne popujt e Evropës Juglindore për atë që na ka ndodhur. Përkujto, mos harro çka ka ndodhur, por në të njëjtën kohë edhe intrigo veten për projeksionin në të ardhmen. Asnjë libër i shenjtë mbi bazën e të cilit veprojnë komunitetet fetare në Kosovë nuk ka porosi tjetër përveç kësaj që thash në mënyrë të parafrazuar. Atë moment kur udhëheqësit shpirtërorë të komuniteteve të ndryshme fetare bëhen pjesë e këtyre proceseve, unë konsideroj se do të jemi mbështetës të idesë së KOMRA-s dhe sigurisht se fuqizimi i kësaj ideje do të jep edhe rezultatet e ardhshme. Unë ju falënderoj për vëmendjen dhe jam i nderuar që pata rast të bashkëbisedoj me juve në këtë takim të këtij formati. Ju faleminderit!

Bekim Blakaj: Profesor Hasani, ju faleminderit shumë për këtë fjalim shumë impresiv dhe për porosinë e urta që na i dhatë si dhe për cilësimin e lartë të Iniciativës për KOMRA-n. Tani, të nderuar të pranishëm, do e hapim debatin. Meqenëse i gjithë ky fjalim, i gjithë ky debat këtu incizohet dhe nga ky nxirret një lloj raporti, kisha pasur dëshirë të ju lus edhe një herë që, kur ta merrni fjalën paraprakisht të prezantohet edhe një herë në mënyrë që të jetë edhe kjo pjesë dhe me këtë të përgatitet raporti nga ky takim. Tani kisha lutur, kush ka dëshirë të marrë fjalën?

Ramadan Shkodra: Përsëritës të gjithë iniciativën. Ndihem i nderuar që jam këtu në mesin e zonja Kandiç si aktiviste shumë e madhe dhe që ka bërë shumë për viktimat ose për krimet që kanë ndodhur në territorin e ish-Jugosllavisë. Mbështesim pra iniciativën për KOMRA-n por dua t'i them disa gjëra sa për të sqaruar disa gjëra. Kam dëgjuar me shumë vëmendje fjalën e profesorit Hasani, me të cilin njihemi kaheerë. Është një profesor i respektuar dhe i cili ka kontributet e tij në këtë fushë. Por megjithatë dua të them se bashkësitë fetare në Kosovë pas lufte janë ndër të para institucione që kanë vu një bashkëpunim të ndërsjellë dhe kanë themeluar Këshillin ndër fetar dhe atë në nivelin më të lartë. Kanë kontributet e tyre, kanë përkrahur, kanë pasur takime të nivelit ndërkombëtar, ku kanë qenë të përfaqësuar tri komunitetet fetare

tradicionale: ish myftiu i Kosovës, doktor Boja, ish ipeshkvi i nderuari i Ipeshkvisë Sopi, si dhe përfaqësuesit e respektuar nga Manastiri i Deçanit. Me këtë dua të them se për aq sa u është dhënë mundësi, aq sa kanë pasur ambient, bashkësitë fetare në Kosovë kanë bërë dhe janë munduar të japin kontributin e tyre. Po edhe vetë pranimi i ardhjes sot këtu i katër komuniteteve fetare, që po i shoh unë këtu, është një mbështetje e iniciativës, profesor, se këtu janë përfaqësuesit e Bashkësisë Islame, me bekimin, me urdhërin e myftiut, përfaqësues të Kishës Katolike dhe sigurisht edhe këta me urdhërin e ipeshkvit të nderuar dhe përfaqësuesit e Kishës Protestante, si dhe përfaqësuesit e Kishës Ortodokse. Konflikti në Kosovë ose në territoret e ish-Jugosllavisë, unë kujtoj se nuk e ka shkaktuar bashkësinë fetare, edhe pse kanë ndoshta përgjegjësi që shpeshherë janë përdorur, nëse mund të them si motivues ose si vegël, por iniciativën e mbështesin. Kjo ishte sa për sqarim. E kam edhe një sqarim, profesor, nuk e di sa pajton ti. E quajte konfliktin serbo-shqiptar, konflikt si ishte ajo... episodik. Nuk është edhe krejt episodik. Është mendim imi. Megjithatë, serbët dhe shqiptarët kanë një problem, kanë problemin që dihet, e kanë problemin për territore dhe mendoj që është ardhur koha që ndoshta do të zgjidhet me vetë zgjidhjen e statusit të Kosovës do të zgjidhet edhe ai problem dhe ne sot këtu jemi më të relaksuar, flasim në mënyrë ma të... Ti na e more edhe shembullin e Norvegjisë. Po norvegjezët dhe gjermanët e kanë zgjidhur problemin. Nuk kanë më kontest dhe ata e shohin njëri-tjetrin në sy. Edhe ne mendoj se me komunitetin serb do ta shohim njëri-tjetrin në sy dhe do të fillojmë që të njohim krimet që i kemi bërë. Ndërsa, nëse kam kohë, do t'i them dy gjëra që i kam nga përvoja ime. Unë si gazetar, ose si publicist, në vitin që shkoi më ka ra që të hartoj një monografi për punëtorët tanë – imamët tanë të cilët kanë rënë gjatë luftës, që janë mbytur gjatë luftës. Dhe këtu kam pa atë që e tha profesori, këtu jam përball me familjet të cilat kanë njerëz të humbur, me fëmijët jetimë, të cilët kërkojnë një drejtësi, që donë me u shprehë, te secili gjen një rrëfim në veti, gjend rrëfim në atë se si është nxjerrë nga turma dhe është burgosur, është torturuar. Gjen rrëfim në vete se si është vra, si është vra për shembull djali para syve, vajza para syve. Gjend rrëfim, që më ka ra të dëgjoj rrëfimet e burgut të Dubravës, më ka ra të dëgjoj rrëfime tjera të depërtimeve. Mbështes zonjën Kandiç dhe iniciatorët e saj se ka nevojë për dëgjime publike, ka nevojë që njerëzit të shprehen dhe nga shprehja as komunitetet fetare, as komunitetet nacionale, as ky popull nuk do të humb gjë por do të relaksohemi dhe do ta njohim situatën në sy, do ta njohim realitetin që është. Kur e njohim realitetin që është, ajo çka ka ndodh ka ndodh, më nuk kthehet. Ai regjim që i ka shkaktuar këto vuajtje, ka dashur zoti dhe shyqyr zotit më nuk është, është klimë tjetër. Interesi i përbashkët që na lidhë edhe si komunitete fetare, edhe si komunitete nacionale, edhe si shtete që jemi në këtë vend, është integrimi drejt Evropës dhe shikimi i gjërave përpara. Kaq kisha unë, nëse nuk e kam zgjat. Ju falënderoj!

Bekim Blakaj: Faleminderit shumë, zotëri Shkodra. Tani do ta ketë fjalën profesorit Hasani!

Ismajl Hasani: Jo për të abuzuar me kohën e respektuar të folësve që vijnë, por në kontekst të shikimit, vetëm shkurtër të asaj që unë me përgjegjësi të plotë dhe njerëzore them se konflikti midis serbëve dhe shqiptarëve është i natyrës episodike. Në qoftë se si studiues kam parasysh historinë e njerëzimit dhe ngulitjen e sllavëve të jugut, përkatësisht autoktoninë e shqiptarëve, nuk e trajtoj si periudhë që fillon me shfaqjen agresive të regjimit të Millosheviqit. Këto janë dy histori të ndryshme. Domethënë unë kam parasysh mbështetjen jo me retorikë por ato që janë

prova historike të koalicionit antiosman të betejës së Kosovës në vitin 1389 në të cilën serbët dhe shqiptarët nuk kanë luftuar njëri kundër tjetrit por janë vu në krah të mbrojtjes së këtij territori, i cili nuk e di kush do t'ia jepte më vonë të drejtën për të qeverisë, është normale se shqiptarët kanë qenë këtu vazhdimisht të hendikepuar, iu janë marrë trojet dhe unë pajtohem me zotëriun Shkodra në atë drejtim. Por, gjithnjë në studimet e ndryshme historike, në analizat dhe refleksionet e ndryshme shkencore historia nuk trajtohet vetëm ajo që ka ndodhur dje, që e kemi të freskët. Historia është e vjetër dhe në këtë kuptim unë konsideroj se ka plotë raste tjera në globin tokësor të konflikteve ndëretnike të cilat zgjasin me shekuj. Është e vërtet se këtu ka pasur edhe konflikte tjera midis serbëve dhe ... por ka pasur dhe sot ka harmoni ndermes serbeve dhe shqiptarve qoftë në mënyrë të hapur qoftë edhe nganjëherë edhe sinkretike. Këtë e dimë ne të gjithë. Kaq, faleminderit!

Bekim Blakaj: Ju faleminderit shumë! Unë kisha pasur dëshirë që të dëgjojë nga ju më shumë reflektime mbi rolin e bashkësive tuaja fetare në një proces relaksim të mardhanjet të themi i cili do të na shpije deri tek një pajtim ose eventualisht nëse dikush ka ndonjë pyetje lidhur me iniciativën për KOMRA, besoj se panelistet janë të gatshëm të përgjigjen. Zotri Sinani më duket se e ka kërkuar fjalën pak më herët pastaj, Kujtimi dhe zotëri Flugaj.

Ajni Sinani: Jam Ajni Sinani, teolog nga Bashkësia Islame. Edhe unë gjithashtu përshëndes këtë iniciativë, përshëndes po ashtu edhe pjesëmarrësit. Unë sa dëgjoja këtu, sidomos në pjesën e parë, pat mesazhe afrimi dhe edhe qëllimi i KOMRA-s është ky, prandaj ne si popull, si bashkësi të afrohem me njëri tjetrin. Gjithashtu u theksua këtu, po edhe nga zonja Kandiq u theksua dhe u përmend edhe nga disa folës tjerë dhe u tha se historia e shkuar nuk duhet të harrohet, por gjithmonë për historinë e shkuar ne duhet të flasim mbi faktet. Profesor i nderuar zotëri Hasani, është fakt, ne për ta trajtuar historinë e shkuar në mes popullit shqiptar dhe popullit serb, por është një fakt i pakontestueshëm historik se raportet në mes popullit shqiptar dhe popullit serb për fat të keq nuk kanë qenë si duhet dhe gjithashtu edhe ai gjenocidi i fundit që ka ndodhur në Kosovë nuk ka ardhur, ndodh rastësisht. Ju edhe para ardhësit e perandorisë osmane, e dini mirë, se kjo tokë shqiptare, Kosova dhe shumë troje tjera shqiptare kanë qenë të pushtuar nga Serbia. Prandaj, edhe me largimin e perandorisë osmane për fat të keq me bekimin e shteteve perëndimore është bërë copëtimi i trojeve tona shqiptare në mënyrë të padrejtë si për asnjë popull, për asnjë vend tjetër në Evropë, për arsye që na pak a shumë i dimë, por nuk dua të ndalem këtu. Sigurisht kemi një të shkuar shumë të hidhur, por u theksua këtu se atë të shkuar nuk duhet ta harrojmë, por gjithmonë duhet të mendojmë mbi të ardhmen por të ardhmen ta ndërtojmë me një frymë tolerante, me një frymë të respektit të ndërsjellë qoftë si popull, qoftë si bashkësi fetare dhe unë mesa pash nga profesori Hasani i përmendi dy bashkësitë fetare dhe ndoshta e kam gabim por më duket sikurse u vu një lloj krahasimi në mes të bashkësisë islame dhe bashkësisë së fesë ortodokse. Unë nuk kam ardhur këtu për këtë qëllim por mendoj se është gabim, sepse këtu në Kosovë kemi pasur një popull që është shtypur, është vrarë dhe kemi pasur, unë do ta them këtë, sepse e dimë fort mirë, se ka pasur edhe priftë ortodoksë të cilët kanë dalur dhe i kanë bekuar ato krime që i kanë bërë ata paramilitarë serbë në Kosovë, ata paramilitarë që kanë vra këtu civilë, pleq, gra dhe të gjitha ato, kurse në anën tjetër nuk kemi pasur dhe unë nuk di që ka pasur ndonjë hoxhë i cili ka dal dhe e ka bekuar luftën tonë duke bërë thirrje për t'i vrarë

civilët serbë. Ndoshta ka pasur vrasje civile këtu në Kosovë...mirëpo... Prandaj, prapë po them duhet të jemi të kujdesshëm për këtë, jemi për atë që të ndërtojmë të ardhmen tonë mirëpo të jemi të kujdesshëm sepse megjithatë edhe sot e kësaj dite, kur ne sot në këtë moment kur po flasim, megjithatë pretendimet e Serbisë ndaj Kosovës nuk kanë pushuar. Dhe mendoj se edhe qëndrimi i kishës serbëve në këtë drejtim nuk është objektiv. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit! Megjithatë, unë ju kisha lutur që t'i përmbahemi temës dhe të shohim se sa çfarë roli do të mund të kenë bashkësitë fetare në ripajtimin. Në ndërkohë, zonja Kandiç, e kërkon fjalën shkurtimisht dhe pastaj tjerët me radhë.

Nataša Kandić: Unë dëshiroj vetëm të vënë në dukje se, ekziston një moment për të cilën ne mund të themi se është një moment i ri për ndryshimin e marrëdhënieve mes komunitetit shqiptar dhe serb dhe për të krijuar marrëdhënie të reja në rajon. Kjo iniciativë është pikërisht ajo që ofron një marrëdhënie të re. Eja, pra që të gjithë, secili nga këndvështrim profesionit të vetë, nga feja e vetë të ndihmojë në këtë. Të gjithë në territorin e ish Jugosllavisë jemi të njohur si shoqëri, kombe, komunitete, qytetaret të cilët në të vërtetë debatojnë ... debate historike për të kaluarën. Ka pasur në këto diskutime tona propozime për të nisur nga Beteja e Kosovës. Me këto propozime, ne kurrë nuk do të arrijmë askund. Dhe kur Desmond Tutu, priftit të njohur, fituesit të çmimit Nobel, i cili udhëhoqi Komisionin e Afrikës së Jugut për të Vërtetën dhe Pajtimin, kur ja propozuan për të shkuar 300-400 vjet më parë për të ardhur deri tek faktet dhe të vërteta, ai tha sillni dëshmitarët dhe unë me plot dëshirë do të kthehem në të kaluarën. Domethënë, shkojmë në atë që viktima dëshmitar të na ndihmon në atë çka në vetë nuk mund ta bëjmë. Duke dëgjuar zërin e dëshmitarit është e qartë se ne nuk mund të kthehemi në Betejën e Kosovës, nuk ekzistojnë, ju lutem, nuk ekzistojnë na jepni si ajo anëtarja e komisionit të Marokut, për të treguar se këto viktima janë të rëndësishme, derisa ende i kemi, të kemi bashkëndjenje për to, që mund të formojmë marrëdhëniet tona dhe ndajë historisë dhe ndaj kaluarës dhe që të kemi një qëndrim autokritik ndaj të kaluarës duke dëgjuar ata që kanë vuajtur, nuk kemi vuajtur të gjithë, siç kanë pësuar ata. Nëse vazhdojmë me çështjen e territorit, kjo është një çështje shumë e rëndësishme, cila ka sjell deri tek luftërat, por ne do të shkojmë me iniciativën që fokusohet në viktimize, prandaj ju lus eja të tregojmë që jemi në gjendje për të ndikuar, për të ndryshuar, duke filluar nga dhimbja, vuajtjet, ne duam të kujtojmë nuk duam të harrojmë, por ekziston një qëllim, dhe qëllimi është, a e dini se nëse në këtë rajon pas pesëdhjetë vite prapë përsëritet krimi, përgjegjësia është mbi ne sot. Pra, kemi një shans për të ndihmuar që të kontribuojmë për të krijuar një sistem të vlerave, morale, sistemet politik i cili nuk do të lejojë të vije deri tek kjo, në këtë aspekt unë kërkoj nga ju që të ofroni më shumë ide të juaja se si mund të... Ju e dini se nuk është lehtë për të ndërtuar një model, statut të një komisioni të tillë rajonal. Ne qëllimisht sot nuk ju kemi ngarkuar me mendimet e grupeve të ndryshme me atë se çfarë statuti duhet të jetë. A e dini, janë duke u zhvilluar debate të mëdha në lidhje me atë a duhet Komisioni duhet të merret vetëm me faktet në lidhje me krimet e luftës dhe viktima, apo për të hulumtuar shkaqet. Në të njëjtën debat kemi ata të cilët thonë se ky është një komisioni rajonal, dhe duhet të ndalemi tek faktet. Nëse ne do të fillojmë nga shkaqet e luftës nuk do të arrijmë deri tek një kompromis, kurrë nuk do të bëjë asgjë. Ju lutem na ndihmoni, mendoni, mendoni në viktima, por edhe në brezat e ardhshëm. Çka është më së miri, gjithkush ka një pjesë të përgjegjësisë së vetë për atë se çfarë ka ndodhur, dhe

individët dhe jo vetëm institucionet apo politikanët, bashkësitë fetare. E vërtetë është që politikanët e kanë në duar kërkim faljen, por secili prej nesh ka një detyrim për të bërë diçka që mund të kontribuojnë në krijimin e një marrëdhënie pozitive në lidhje me parandalimin për të ndodhë. Prandaj, kjo është diçka më çka ne duhemi të udhëzohemi. Do të kishim zhvilluar diskutimet në nivelin politik frikohem se nuk do të kishim arritur askund ndërsa qëllimi është që nga ky diskutim, të përfshihen në një moment dhe politikanët. Kjo nuk është aspak e lehtë. Është lehtë të udhëheq këtë debat brenda shoqërisë civile, nuk është thjesht për të marrë një hap të domosdoshëm që politikanët dhe institucionet të mbështetnin këtë iniciativë. A nuk e shihni se ky është një instrument që mund të ndihmon të ndryshojnë marrëdhëniet midis serbëve dhe shqiptarëve. Nuk janë vetëm në këtë rajon problemet me serbet dhe shqiptarët, ekzistojnë shumë çështje të tjera të cilat janë të ngarkuara, por ka diçka, një shenjë pozitive në rajon. Nuk është lehtë për të udhëhequr këtë diskutim, më datën 26 qershor kemi pasur të planifikuar diskutimin rajonal me viktima. Është dashur të mbahet në Sarajevë. Kemi qenë të detyruar për ta anuluar. A e dini pse? Për shkak se njerëzit nga Kosova me dokumente të Kosovës nuk mund të udhëtojnë. Ky është problemi ynë. Nëse ne tani fillojmë të diskutojmë, duhet të kërkojmë një zgjidhje, kjo nismë është rajonal dhe ne duhet të sigurohemi që diskutimet të zhvillohen kudo dhe në Bosnje dhe Hercegovinë. Tani e kemi dorëzuar një kërkesë Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe kërkojmë prej tyre që të mundësojnë zhvillimin e kësaj procesi. Pra, ne kërkojmë që njerëzit mund të udhëtojnë. Nuk është në rregull që ne sot kemi pengesa për të udhëtuar. Ne kemi probleme por dhe zgjidhjen e tyre. Në Serbi mund të vijmë të gjithë. Problemet kritike ekzistojnë por shohim se kjo iniciativë mund të kontribuojnë në zhgënjim, mund të kontribuojnë në qoftë se pranohen faktet për atë që ndodhi. Prandaj është ky hap i nevojshëm drejtë respektit, kujtimit, pajtimit, krijimit një përkujtimi të përhershëm. Njohjen, atë që ju e përsërisni, njohjen e asaj se çka ka ndodhur, kanë ndodhur krime të tmerrshme.

Bekim Blakaj: E falënderoj Natashen, fjalën e ka kërkuar zotëri Flugaj, pastaj Arturi. Urdhëroni!

Fitim Flugaj: Unë jam Fitim Flugaj, përndryshe sot përfaqësoj kryesin e bashkësisë islame zyrtar nga bashkësia islame. Në vend të parë do t'u tregoj se dy projekte nacionale në të cilat mora pjesë si përfaqësues bashkësisë islame. Njeri projekt ishte lufta kundër trafikimit qenies njerëzore dhe projekti tjetër është karvani i paqes. Për fat të keq në ato dy projekte nuk ka qenë pjesëmarrës kisha ortodokse serbe dhe sot përshëndes në radhë të parë përfaqësues të kishës ortodokse serbe që sot janë bashkangjitur këtë projekt se janë bashkangjitur këtë projekt, me lejoni të përshëndes miqtë nga kisha katolike e Kosovës gjithashtu nga kisha protestante, evangjelistë dhe mbi gjitha përshëndes zonjën Kandic e cila ka merita të mëdha në drejtim të luftës kundër të padrejtave që i bëhen popujve dhe njerëzve por natyrisht profesorin e nderuar Hasani dhe të gjithë panelin që e udhëheq sot këtë takim shumë të rëndësishëm. Unë në emrin e kryesisë bashkësisë islame përcilli përshëndetje më të sinqerta myftiut dhe gjithë kryesisë bashkësisë islame dhe gjithashtu përkrahjet që i japim KOMRA-s e cila është një iniciativë e qëlluar në drejtim të nxirjes së argumenteve, nxirjes në pah argumenteve për krimet e bëra në territorin e ish Jugosllavisë që nga viti 91 deri në vitin 2001 gjë që ne e çmojmë e vlerësojmë jashtë zakonisht lartë këtë iniciativë dhe jo ashtu siç tha profesor Hasani se në mënyrë deklarative dot

e përkrahi por faktikisht vet prezenca një numri shumë të madh këtu të krye imamëve dhe përfaqësuesit nga bashkësitë, këshillave bashkësisë islame si nga Gjakovës, Prizreni në radhë të parë, Mitrovicës, Suharekës, Rahovecit, Pejës, të gjithë këta japin argumente që ne defakto, po e përkrahim fuqimisht këtë iniciativë e cila në të ardhmen besojmë që do të sjell rezultate shumë të mira në drejtim të pasqyrimin e fakteve mbi gjithat viktimat dhe krimet që janë bërë. Bashkësia islame e Kosovës dihet që ka qenë një nga institucionet më të dëmtuara pas luftës së fundit që u zhvillua në Kosovë me shkatërrimin e shumë kulteve fetare dhe më një numër mjaft të madh martirëve apo dëshmorëve që kanë dal nga dyert e medreseve, kanë qenë punëtorët e bashkësisë islame. Bashkësia islame natyrisht që çdo iniciativë e cila ka të bëjë me këto çështje të cilat sot iniciohen këtu në këtë takim është gjithmonë përkrahës dhe ka qenë përkrahës si vetë myftiut si më parshi doktor Boja gjithashtu i tanishmi magjistri Naim Tërnavë. Nuk kanë pritua të shkojnë aty ku janë caktuar takimet ndërfaqetare qoftë në takimet e fundit në manastirin e Deçanit, në Vjen dhe kudo, gjë që asnjëherë nuk kemi neglizhuar që të jemi aty ku kërkohet për hir të humanitetit dhe njerëzimit, për hir të asaj që njerëzimit ti falim paqen dhe të kthejmë rahatën dhe stabilitetin ku do në çdo hapësirë, jo vetëm në Ballkan, por edhe në Evropën juglindore. Çdo që edhe kësaj radhe ju them me plot bindje se bashkësia islame më gjithë potencialin që ka do të ven në shërbim të humanitetit, në shërbim të vet iniciativës edhe të KOMRA-s edhe për kundër asaj bashkësia islame mendon të ketë iniciativa të saja të cilat shpresonim që do ti përkrahin edhe të tjerët në drejtim të saj që të sjellim sa më shumë paq stabilitet dhe qetësi në këto treva ku jetojmë dhe frymojmë në veçanti kuptohet Evropën juglindore ku ne duhet të luajmë rolin tonë për të sjellë sa më shumë paq dhe siç e potencoi profesor Hasani për të arritur deri tek një rikoncilim ose një pajtim në mes popujve sepse në fund të fundit ne kthehemi në parimin që na jep ajeti kuranor ku thotë : O, ju njerëz të gjithë jeni të krijuar nga një nënë dhe një baba, ju kemi bërë popuj e kombe që të njiheni nder mes vete, të bashkëpunoni nder mes vete, jo duke u mburr ndaj njëri tjetrit, se unë jam shqiptar, unë jam serb, unë jam boshnjak, unë jam malazez, unë jam turk, unë jam arab, po që të bashkëpunoni të njihni njëri tjetrin, të bashkëpunoni nder format më të mira, po më i miri nga mes i juaj thotë zoti: Nuk jeni as një komb as një popull por jeni ata të cilët jeni më të sinqertë ndaj zotit jeni më të devotshmit dhe mbi gjithat doni, keni parasysh, apo ndryshe kontribuoni në humanitetin e vërtet njerëzor. Çdo që bashkësia islame duke u mbështetur në këtë parim, mendoj se gjithmonë do të kontribuon në arritjen e interesit e gjithë njerëzor. Nëse arrihet interesi i gjithë njerëzor atë herë natyrisht aty do të mbrohet dhe interesi personal apo individual i njeriut dhe kështu që të gjithë do të jetojmë në paq. Prandaj edhe njëherë po ju them se koalicioni për KOMRA do të ketë përkrahjen e plotë bashkësisë islame duke marr parasysh se bashkësia islame posedon një strukturë për hapjen e anekënd të Kosovës, mbar Kosovën dhe nëpërmjet asaj ajo që do ti kërkohet bashkësisë islame, bashkësia islame do të jetë ajo e cila do të jep kontributin e vet. Ju falënderoj për vëmendjen dhe besoj së e ardhmja do të jetë në të mirën e njerëzimit, në të mirën e atyre të cilët më të vërtet e duan paqen, e dua qetësin, dhe asnjëherë në të mirën e atyre të cilët manipulojnë mbrapa perdeve të ndryshme duke u thirr në emër të paqes, por duke vepruar kundër saj. Ju falënderoj edhe një herë dhe shpresoj të kemi sukses në këtë iniciativë.

Artur Krasniqi: Të nderuar përfaqësues dhe të gjithë ju të pranishëm, përfaqësues të bashkësive fetare. Në Kosovë, në gjithë ish-Jugosllavinë edhe në këtë pjesë të Ballkanit roli i bashkësive fetare në të kaluarën ka qenë shumë i vogël, e shpeshherë shumë i manipuluar. Zëri i bashkësive ose i komuniteteve fetare ishte shumëherë i keqpërdorur prej politikës dhe prej veprimeve politike. Sot në këtë kohë të re, ne shpeshherë pyesim cili është atëherë roli i bashkësive fetare.

Më lejoni me thënë, dhe me përmend një thënie të Martin Luter Kingut jo reformatorit por luftëtarit të njoftur të drejtave e të lirive të njeriut në Amerikë. Ai kishte thënë se kisha nuk është përmbi shtetin e as në shtetin por është ndërgjegja e shtetit. Feja nuk është përmbi shtetin as në shtetin por është ndërgjegja e shtetit. Unë besoj se kjo iniciativë duhet të na ndihmojë gjithë neve si bashkësi fetare, e si shoqëri, të gjithëve së bashku për të prekur ndërgjegjën, për të zgjuar ndërgjegjen e kësaj shoqërie. Nga Bibla ne lexojmë thënien: se ju do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do të ju bëjë lirë. E vërteta do të ju bëjë të lirë! Nga e vërteta askush nuk duhet me pas frikë. Në fakt veç gënjeshtër, rregna duhet me u friksua prej të vërtetës. Zotit, të cilit ne të gjithë i shrëbejmë, është zoti i patjimit dhe zot i faljes. Ai na thirrë në pendim dhe ai na thirrë në falje. Nëse ne e duam atë, ai na mëson që të falim dhe të duam tjetrin. Perëndia të cilit ne i shërbejmë na thirrë që të jemi në anën e atyre që janë të shtypur, atyre që janë të lënë dhe atyre që janë të vuajtur. Perëndia, o zot, na thirrë si shërbëtorë të tij që të jemi ambasadorë të paqes e ambasadorë të faljes. E të qenurit neutral në jetë, jo gjithmonë, është neutral. Ne jemi thirrë, qëndrojmë në anën e atyre që janë të shtypur. Konkretisht, ne duam si kishë të jemi në anën e atyre që ndërtojnë dhe jo e atyre që shkatërrojnë, të atyre që mbjellin paqen e jo luftën, të atyre që besojnë fort se dashuria është më e fortë se urrejtja dhe se falja është më e fuqishme se hakmarrja. Ne duam të jemi jo veç përkrahës, por edhe pjesë e kësaj iniciative. Më lejoni të përmend një tregim nga Bibla, rastin e Kainit dhe Abelit, kur Kaini kishte vrarë vëllaun e tij Abelin. Perëndia i kishte thënë se gjaku dhe zëri i gjakut të tij po thirret për drejtësi. Ne besojmë se është një zë i gjakut të pafajshëm të njerzëve që kanë humbur në këtë vend, i cili thërret për drjetësi e këtë zë ne duam ta bëjmë të dëgjueshëm, që njerëzit të kenë mundësi me dit se ka një zë të gjakut të pafajshëm që është derdhë në këto vatra. Ne nuk duam edhe një herë të jemi veç përkrahës e të mbështesim këtë iniciativë, por ne duam të jemi pjesë aktive e saj. Shumë faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit shumë për këto fjalë të urta dhe për përkrahjen e nishmës për REKOM. Tani do ta marrë fjalën Don Pal Tunaj.

Don Pal Tunaj: Ne përshëndesim të gjithë iniciatorët e kësaj iniciative të KOMRA-s. Ne gjithë e dimë se njeriu është rruga e parë themelore e kishës, pra bëhet fjalë për çdo njeri, pa dallim feje, pa dallim kombësie, prejardhje apo edhe përcaktimi. Prandaj Kisha Katolike e Kosovës mbështet çdo iniciativë qoftë ajo kombëtare apo ndërkombëtare për të arritur një pajtim por sidomos edhe një dënim të gjitha atyre krimeve që kanë ndodhur në territorin e Ballkanit. Ne jetojmë sot në kohë shumë të vështira dhe tranzicionit, apo kalimit nga një shoqëri politike në shoqërinë tjetër, të një mentaliteti të ri politik, të cilin sot na e ofron bota perëndimore. Koha në të cilën jetojmë është edhe një kohë me shumë probleme dhe aktuale të cilat po dëshmojnë edhe sot në tryezën tonë. Ne nëpërmjet këtij bashkimi ndërkombëtar jemi të gatshëm të japim kontributin ashtu sikur që e kemi dhënë kontributin çdoherë gjatë historisë, sidomos në pesë shekujt e fundit ku Kisha Katolike në këto territore ka qenë zëri i atyre që s'kishin zë për t'i dënuar të gjitha ato vepra që kanë instrumentalizuar emrin shtet, që e kanë instrumentalizuar emrin komb, që e kanë instrumentalizuar emrin zot për qëllime të pushtetit, për qëllime të krimeve, por sidomos për qëllime hakmarrjeje dhe të cilat kanë vijuar dhe janë zhvillua sidomos në vitet e 90-ta. Nuk besoj, dhe besoj se asnjëri prej jush nuk beson në ata njerëz të cilët kanë vrarë në emër të zotit e të kenë besuar në zotin. Ne këtë gjë duhet ta dënojmë ashpër sepse njerëzit të cilët nuk kanë përgjegjësi fetare nuk guxojnë të flasin në emër të institucioneve përpara popullit sepse ne jemi përgjegjësit e

institucioneve tona fetare. Ndërsa, politikajt mund të flasin vetëm në emër të politikës, në emër të shteti dhe në emër të aspiratave që i ka shteti dhe politika e atij personi. Prandaj, një përgjegjësi serize duhet ta përdorim që nga fillimi i kësaj iniciative të KOMRA-s. Fillimisht lufta, paqja, demokracia po edhe vetë fjala integrim për të cilën ne sot dhe në çdo shtet tonin flitet shumë janë secila për veti tema të gjera, sepse një rol të rëndësishëm luan edhe historia aktuale të cilën po e zhvillojnë shtetet dhe të cilat po e zhvillojnë edhe politikat e Ballkanit. Prandaj, ne e dëshmojmë përsëri haptas se Kisha Katolike është e hapur ndaj dialogut sikur çdo herë gjatë historisë, por shpresojmë që përmjet këtyre forumeve, iniciativave, ne të arrijmë një bashkim dhe njëzëri të gjitha bashkësitë fetare të distancohen nga ato veprime që kanë kanosur luftëra dhe që njëzëri ne ato duhet t'i dënojmë dhe së bashku ta favorizojmë bashkëjetesën ndëretnike dhe ndërfitare. Ne të gjithë, si bashkësi fetare e predikojmë dashurinë, dashurinë ndaj të afërmit, ndaj të afërmit pa dallim feje, pa dallim race, pa dallim etnie. Prandaj, unë uroj që të ato predikime tona, fjalime tona, mesazhe, porosi por edhe vetë doktrinat tona të jenë me të vërtetë të kalitura mirë në porositë e bashkëjetesës ndëretnike dhe ndërfitare në të gjitha shtetet dhe në gjithë territorin ballkanik. Pra, ne e përshëndesim këtë iniciativë dhe do të jemi aktivë sikur që tha zotëri Arturi, jo vetëm vëzhgues por do të jemi aktivë me mundësitë tona që të zbardhim të gjitha faktet për të cilat edhe e kemi detyrë dhe mision përpara popullit.

Bekim Blakaj: Ju faleminderit shumë, i nderuari Don Pal Tunaj! Në ndërkohë fjalën e ka kërkuar edhe kryeimami Rexhep Lushta!

Rexhep Lushta: Përshëndetje për të gjithë, veçanërisht për zonjën Kandiç, për panelistët, për liderët fetarë për iniciativën, sidomos për liderët e Kishës Ortodokse Serbe të cilët kanë marrë guximin që sot të jenë me ne. Padyshim se KOMRA si një proces i cili në statutin e vet ka për qëllim hulumtimin e rasteve të viktimave dhe zbardhjen e viktimave të luftës në rajonet e ish-Jugosllavisë, së pari për një nevojë të madhe dhe përkrahje nga të gjitha bashkësitë.

Edhe në takimet e mëhershme në të cilat kam marrë pjesë si në Prishtinë, Mitrovicë, Novi-Sad, unë kam shprehur shqetësimin tim pse nëpër ato takime nuk kanë qenë përfaqësuesit fetarë dhe kam dhënë idenë dhe propozimin që pjesë e këtij procesi, pjesë e këtij komsioni të jenë edhe liderët fetarë duke pasur parasysh ndikimin e madh të tyre në popullatë. Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm për atë çka ka ndodhur në rajonin e ish-Jugosllavisë, ashtu siç tha e tha edhe zotëri Ajniu ne të kaluarën kurrnjëherë nuk duhet ta harrojmë as kukr duhet ta marrim si një mësim e shembull që të mos përsëritet më kurrë. Mbi të ta ndërtojmë të ardhmen tonë, të ardhmen e fëmijëve tanë dhe ne si bashkësi fetare të jemi një krah i fortë i kësaj iniciative dhe të jemi ata të cilët do të shfrytëzojnë atë potencialin dhe ndikimin tonë tek viktimat që t'i inkurajojmë ata që të dëshmojnë për krimet që janë bërë ndaj tyre. S'ka dyshim se, në qoftë se ndalemi dhe fillojmë me bë prejdukime secili në fenë e vet, secili prej nesh kemi se çka të flasim, kemi shembuj të shumtë për atë se si duhet të trajtojmë ne krimin dhe kriminelin. Unë po ju jep një shembull prej historisë së bujshme të Muhamedit alejiselam të dërguarit të fundit të allahut xheleshanuhu, një rast kur një grua nga fisi Benimahzum kishte vjedhë. Benimahzum ka qenë një fis prej fiseve të ndershme të Mekës. Edhe ata e dërgojnë një djalë te Muhamedi alejiselam të cilin e donte shumë që të ndërmmjetësojë për me ia fal asaj për krimin që e ka bërë. E pengajmeri alehi-selam e ka thënë një fjalë e cila duhet të shërbejë për të gjithë neve. Thotë: vallahi, sikur edhe Fatimja, e bija e Muhamedit të kishte me bë krim kam me e dënuar. Me të vërtetë janë nënçmuar, janë mposhtë ata popuj të cilët kur fisniku i ndershmi prej tyre e ka bërë ndonjë krim e kanë liruar, ndërsa kur i dobëti ka bërë krim e kanë ekzekutuar. Dhe ne nga këtu ta marrim një mësim, se krimineli, pa marrë parasysh se i cilës kombësi është, ai është kriminel dhe ai duhet të dalë para drejtësisë dhe atij duhet t'ia japim atë që e meriton. Sa i përket të vërtetës, ne si njeërz, në aspektin fetar, si përgjegjës fetarë që jemi, jemi të thirrur që gjithmonë ta flasim të vërtetën dhe vetëm të vërtetën,

po qoftë se ajo e vërtetë është edhe kundër vetëvetes tonë. Dihet fare mirë se ai i cili pajtohet me krimin apo e fsheh krimin ai është pjesë e krimit. Prandaj, duke mos dashtë me zgjatë më tepër unë them që ne si liderë fetarë të luajmë rolin tonë tek popullata jonë, secili në hapësirën e vet, në territorin e vet, në qytetin e vet, në fshatin e vet, në lagjen e vet, në familjen e vet dhe të ushtrijmë ndikimin tonë tek njerëzit që krimet të cilat janë bërë kundër njerëzimit në këto hapësira të ish-Jugosllavisë në këtë periudhë e cila është përcaktuar edhe në mandatin e KOMRA-s që ata të dëshmojnë për to. Ne e pamë edhe Komisionin e Marokos, i pamë edhe atë xhirimet kur njerëzit fillimisht kanë shpreh atë neglizhencën e tyre dhe mosguximin e tyre për me dëshmuar për krimet. Prandaj, ne duhet të jemi ata të cilët duhet t'i inkurajojmë ata që të flasin, që të dëshmojnë në mënyrë që kriminelët pa marrë parasysh se cilit nacionalitet apo cilës përkatësi fetare u takojnë ata të dalin para drejtësisë dhe drejtësia të merret me ta. Unë edhe një herë shpreh falënderimin tim dhe përkrahjen e plotë edhe në emër të Bashkësisë Islame, siç e shprehu edhe zotëri Flugaj në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame për këtë iniciativë dhe shpresojmë se ky nuk do të jetë takimi i fundit i bashkësive fetare por me shpresën se edhe pas vendimit të GJND-ës për Kosovën dhe pavarësinë e saj do të ndryshojë edhe një realitet tjetër, edhe një mentalitet tjetër, edhe i popullatës serbe lidhur me realitetin e ri i cili po krijohet në Kosovë dhe që bashkërisht të fillojmë ta ndërtojmë një të ardhme më të mirë për të gjithë ne. Ju faleminderit.

Bekim Blakaj: Ju faleminderit shumë, i nderuari kryeimam, Rexhep Lushta. Kjo na la përshtypje për një punë konkrete, domethënë puna në mes bashkësive fetare, përkrahja e KOMRA-s kishte me qenë një inkurajim i viktimave që të dëshmojnë dhe atëherë kur të formohet komsioni sigurisht se të gjitha bashkësitë fetare sa e di unë kanë materiale, kanë prova për krime të ndryshme dhe komsioni sigurisht se do të ketë nevojë t'i posedojë ato prova ose të konsultohet për gjetjen e dëshmitarëve për këto sesionet e dëgjimeve publike. Duke iu falënderuar edhe një herë, ju kisha lutur që të shprehni gatishmërinë për përkrahjen e koalicionit për KOMRA e këtu ju kisha bërë me dije se këtu keni një deklaratë të bashkëngjitur dhe këtë mund ta nënshkruani edhe në emër të institucionit të cilin e përfaqësoni por edhe në emrin tuaj personal. Në ndërkohë, ju e keni kërkuar fjalën, urdhëroni!

Nysret Abazibra: Nysrat Abazibra, kryeimam. Në fillim i përshëndes të gjithë të pranishmit, sidomos profesorin shumë të nderuar Hasani. Më herët është përmendur roli i bashkësive fetare për dhënie të kontributit në evitimin e problemeve dhe me këtë rast dëshiroj të theksoj disa çështje të cilat ne si komunitet që jemi në Rahovec, paso që jemi një komunitet multietnik sepse në mesin tonë kemi sikur që është fshati Foça e Madhe, fshati Zeqishtë ku ka pjesëtarë të komunitetit serb dhe ne si bashkësi islame kemi dhënë kontributin tonë aq sa kemi pasur mundësi që të përmirësohet atmosfera e pasluftës, prandaj ne kemi marrë pjesë aktive në komisionet komunale për kthimin e të zhvendosurve pastaj për ndërtimin e kishës në Zoqishtë e po ashtu edhe për kthimin e të zhvendosurve në këtë fshat. Por, për të pasur sukses KOMRA apo iniciativa e KOMRA-s mendoj që është e rëndësishme së veçantë edhe të përcaktohet definicioni i viktimës, nga se ne po flasim për viktimë mirëpo si duket, apo unë për veti, megjithë parafolësve apo iniciatorëve e KOMRAS, mirëpo nuk po mundem me kuptuar definicionin e viktimës, kush është viktimë, ngase nga ky lloj thirrjeje për pajtim sikurse po bëhet një lloj barazimi i agresorit apo i shkaktarit të viktimave. Mendoj se këtu duhet të sqarohet sepse nuk do të arrijmë ndonjë sukses nëse ne shkojmë kah ajo që ne vetëm duhet të falim. Pra, këtu është me rëndësi dhe duhet bashkësitë fetare që përfaqësojnë komunitetin e vet të kenë atë guxim dhe ta pranojnë një fakt të pamohueshëm se asnjë viktimë, tash po e jap mendimin tim, pa ndonjë... asnjë viktimë nuk ka ndodh nga ana e shtetasve serbë. Askush, asnjë serb nuk është vra në Serbi, unë mendoj kështu. Është vrarë jashtë territoreve të Serbisë. Pra, janë vra serbët në Bosnje, janë vra në Kroaci, janë

vra, nëse ka ndodhur, në Kosovë mirëpo në territorin serb nuk ka ndodh. Pse nuk ka ndodhë kjo? Për arsye se nga territori serb.... nga shteti serb janë ngarkuar njerëzit për luftëra, prandaj kjo, mendoj, është shumë me rëndësi të definohej këto gjëra dhe të mos barazohet viktima me agresorin. Ja, kjo më e fundit, dëshiroj të potencoj pa pasur dëshirë që të nxehet atmosfera. Festimi i festës së luftës – betejës së Kosovës, kanë marrë pjesë direkt klerikët nga kisha ortodokse. Për mua ishte shumë kontradiktore, shumë e pakuptimtë të shohësh njerëz të cilët brohorisin në atë tubim – “ubij shiptara” kurse prijësi i tyre flet, pra kleriku ortodoks flet dhe e përshëndet atë tubim. Kjo është diçka me të vërtetë nuk guxon të ndodhë, nga se është prekje për këto viktima, sepse kanë qenë shkaktarë të këtyre viktimave. Ndoshta tash nuk kanë mundësi ta bëjnë atë që e kanë bërë, mirëpo me forma të tjera, fryma apo ajo atmosfera, apo dëshira që është në dukje, ende ekziston, fatkeqësisht. Prandaj, këtu dëshiroj ta përkrah iniciativën e KOMRA-s dhe me të vërtetë është një iniciativë shumë e qëlluar dhe do të kontribuonte shumë në jetën e njerëzve në të ardhmen, mirëpo duhet patjetër që të sqarohen disa gjëra dhe çdo kush ta marrë atë guximin që ta pranojë atë pjesë të fajit që i takon atij. Faleminderit! Nuk kam dëshirë më tepër ta zgjas! Faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit, i nderuari Nysret! Në fakt, unë desha të përgjigjem lidhur me atë se shumë shpesh kemi marrë pyetje të tilla lidhur me barazimin e agresorit me viktimën. Mirëpo, si duket zonja Kandiç do të përgjigjet lidhur me këtë, kështu që po ia japim fjalën.

Nataša Kandić: Së pari kush është viktime, sigurisht që ekziston e drejta ndërkombëtare e cila shume çart e sqaron kush është viktim, përshkruan viktimën, lidhur më atë dhe cilat janë viktimat e krimeve të luftës, siç e definojnë e drejta ndërkombëtare viktima e krimeve të luftës mundet me qenë e çdo nacionaliteti. Ekziston diçka që thuhet kolokvium i viktimave, viktimat e krimeve të luftës, viktimat...por mendohet në totalin e humbjeve të njerëzve. Secila shoqëri në luftë ka dhe viktima të krimeve të luftës por ka dhe humbje në pjesëtar të radhëve ushtarake. Ata nuk janë gjithmonë viktima të krimeve të luftës. Pjesëtarët të forcave ushtarake janë viktima vetëm kur nuk janë të armatosur, kur janë të robëruar dhe pastaj të vrarë, atë herë është viktimë e krimeve të luftës. Prandaj këtu ekziston një definicion shumë i qartë se kush është viktimë e kush i takon listës humbjeve njerëzore. Këtë më së mirë do të shpjegojnë përfaqësues të Kishës Katolike dhe Kishës Ortodokse por besoj dhe Bashkësisë Islame. Ekzistonin llojshmëria e klasifikimit të krimeve të luftës. Ndër një është krimi i luftës, dy është krimi kundër njerëzimit dhe e treta gjenocid, këto janë krime kryesore nën juridiksion të Tribunalit. Doktrina krishtere si dhe doktrina islame thonë se viktimat janë të barabarta si në jetë ashtu dhe në vdekje. Kjo është diçka çka nuk mund të ndryshojmë tani, këto janë doktrina fetare. Nuk ka dalim mes nënës cilës ju vra i biri në Srebrenic dhe nënës e birit i cili është vrarë në Klinë, ose ndonjë pjesë tjetër. Pra, nuk ka barazim në krime lufte, sepse të gjithë duhen respektuar atë që gjykata konstaton se është kryer krimi. Por ne nuk mund të hyjmë në atë që janë parimet dhe postulatet doktrinës krishtere, ideologjisë islame, dhe tjera. Të gjithë ju këtu keni një transkript, apo sugjerime dhe mendime nga konsultimet në Beograd. Dhe janë interesante, ju mund ta lexoni se si teologu kroat Pilsel e shpjegon qëndrimin ndaj viktimave, viktimat në kontekstin e doktrinës fetare në mënyre kolokviale, kështu që nuk jemi të gjithë besimtarët ati niveli që mund të zhvillojmë polemik ose të debatojmë me teologët, por disa parime themelore i disponojmë dhe mund të njoftohemi, por ju lutem, nuk është fjala dhe nuk jemi duke diskutuar për agresorin, nuk ka qenë as në kompetencën e Tribunalit të Hagës përcaktimi i përgjegjësive për aktin e agresionit. Ju të gjithë e dini që u mbajt në Kampalla Konferenca e madhe ndërkombëtare saktësisht për të përcaktuar krimin e agresionit për shkak të funksionimit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, dhe definicioni, definomi ende nuk është kryer, është shtyrë për 7 vite të ardhshme. Pra, ne duhet të respektojmë disa parime ndërkombëtare, diçka çka është e drejta ndërkombëtare, deri ku kanë arritur

zhvillimet, natyrisht e vërteta është diçka tjetër. Ky nuk ka pretendime për të krijuar të përcaktuar të vërtetën. Gjithkush ka të drejtë për vërtetën e vetë, çdo viktimë e krimeve të luftës do të ketë gjithmonë e vërtetë e vetë. Përcaktimi i fakteve mund të kontribuojnë që disa viktimat e kuptojnë dhe atë çfarë nuk është në fushë pamje të tyre. Mund të gjen disa informata më shumë, por atë çka viktimat e përjetoi, ai i cili e ka parë, ishte aty kur ja vranë më të afërt të tij, kur dhe askush nuk mund të ndryshojë dhe nuk i duhet e vërteta e tij. Detyra e kësaj iniciative është të përcakton fakte, aty ku nuk ka njohuri, nuk ekziston pranimi fajësie i përmbushur me fakte, por nuk guxojmë të prekim në vërtetën e atyre që mbijetuan krimet më të tmerrshme. Vetëm kaq desha...!

Bekim Blakaj: Falemnderit Natasha! Po, urdhëroni, zotëri Sinani, prapë e kërkon fjalën!

Ajni Sinani: Shikoni, të gjithë ne jemi këtu për tolerancë, për bashkëjetesë në gjithë Kosovën, sepse të gjitha këto pjesë të popujve e dëshirojnë dhe synojnë Bashkimin Evropian. Dhe e dimë fort mirë se cila frymë domethënë mbizotëron për Bashkimin Evropian. Unë do të ua tregoj juve një shembull, që kam pas patur me një plak serb, kur kam qenë në klinikën e Prishtinës, e kam patur një sëmundje shumë të rëndë që ka qenë gjatë studimeve në Kajro dhe nuk kam mund të shkoj madje edhe në derën e banjove. Këtë plak serb e kam patur me një dhomë tjetër, afër meje, komshi dhe për 10 ditë ai mua më ka ofruar ndihmë. E fliste gjuhën shqipe sikurse një shqiptar i vërtet i Kosovës dhe unë pas 10 ditëve e kam kuptuar se plaku ka qenë serb. I njihte traditat shqiptare, e njihte fenë islame, bile ne bashkë me të kemi biseduar, kam menduar se ishte një shqiptar musliman, sinqerisht po e them. Dhe, pas një kohe, meqë unë banoja në katin e parë të klinikës infektive, nëse s'gaboj, vjen dikush dhe e thërret atë personin, me emrin serb. Unë e kisha dritaren hapur. Nga emri që e thërret ai këtë person, ky personi i jashtëm, unë e kuptova se ky plaku ishte serb. Dhe pastaj, pas gjysmë ore plaku vjenë në dhomën time. Kur afrohet te dera, i them: më falni zotëri, ju kush jeni? Jeni shqiptar, apo jeni serb? Thotë, shiko, zotëri, hoxhë i nderuar, ashtu sikur që ke folur deri më tani vazhdo të flasish prapë, sepse ishte periudha 1988 – 1989 kur kishin filluar të acarohen raportet në mes shqiptarëve dhe serbëve. Thotë, vazhdo të flasësh, se unë jam mësuar në Kosovë, jam mësuar thotë me dobar dan e mirë dita. Djemtë atij i ishin larguar në Serbi, ky kishte vajtur në serbi, kishte jetuar një kohë të caktuar, disa muaj, nuk ishte i kënaqur dhe ishte kthyer në Kosovë dhe thotë unë jam i përbetuar që të jetoj në Kosovë. Do të thotë nuk diskutohet, sepse ne jemi të gjithë për atë që të kemi pajtim, sepse unë thash më parë kanë ndodhur disa gjëra mjerisht në mes popujve tanë dhe ne duam e s'duam, populli serb dhe populli shqiptar do të vazhdojnë që edhe në të ardhmen të jenë fqinjë. Fati dhe zoti i madh ka dashtë që këta dy popuj të jenë në komshi. Dhe unë mendoj, meqë ne të gjithë edhe si njerëz të zotit, pra si teologë të feve të ndryshme, duhet të çojmë mesazhe pajtimi por gjithashtu duhet të themi të vërtetën dhe atë që e themi duhet të besojmë dhe të punojmë në atë drejtim. Unë kam një mospajtim të vogël! Unë kam qenë kryetar i Partisë së Drejtësisë, kam qenë në Kuvendin e Prizrenit, dhe jam mësuar me replika dhe unë e di që kjo nuk ajo natyrë, por megjithatë do ta thoja një gjë, sepse ne këtu jemi mbledh, jemi tubuar për të çojmë frymë pajtimi, mirëkuptimi në mes bashkësive fetare. Mesa dëgjova, zotëri Don Pal Tunaj, tha se Kisha Katolike ka qenë zëri i popullit, i atyre të shtypurve. Unë mendoj që kjo do të ishte gabim të flasim për këtë, sepse e dimë fort mirë do t'i hyjmë një dëmke tjetër dhe prandaj them që të çojmë mesazhe afrimi dhe pajtimi. Ju falemnderit!

Bekim Blakaj: Ju falemnderit, zotëri Sinani! Në ndërkohë, zonja Greta Kaçinari e ka kërkuar fjalën.

Greta Kaçinari: Pra, unë jam Greta Kaçinari. Këtu jam edhe si Gretë, domethënë si individ, por edhe si përfaqësuese e Kishës Katolike në Kosovë. Dhe, mos t'i përsëris të gjitha përsëritjet, me një të madhe: – falemnderit për ftesën që jam këtu dhe për ata që më kanë ftuar të jem këtu. Të ju them të drejtën u lajmërova për fjalën meqë vazhdimisht flisnim, fillova veten ta ndiej si

minoritare edhe pse në të vërtetë unë nuk jam si minoritare edhe pse gjatë tërë jetës kam qenë në minoritet. Minoritet në Bosnje, si fëmijë shqiptar i cili ka jetuar në bashkësi, për shkak të shpërnguljes së prindërve të mi në vitet e 50-ta, jam rritur në Bosnje, kam jetuar një një bashkësi multietnike, multifetare dhe e barti në vete me shumë dashuri ndaj atyre të gjithë njerëzve. Dhe duke u rritur në epokën e Jugosllavisë e cila ishte e lirë për lëvizje në lëviznim shumë dhe mund të ju them se prej të cilit do vend të më pyesnin që ta këndoje një këngë do të jam në gjendje ta këndoje, nga cilido gjuhë e ish-Jugosllavisë që dëshiron. Dhe tash jam vetë në dyshim, a të flas për të kaluarën apo të përcaktohem për të ardhmen. Unë do t'i bëj të dyja. Sepse, pikërisht këto 20 vite kam qenë ato të cilat i barti ende në supet e mia, i barti si një përvojë jo të mirë, si një përvojë të cilën e kam lënë prapa, nuk mendoj shumë për të, por ja po më jipet rasti të flas. Në fillim të viteve të 90-ta, në të vërtetë para viteve të 90-ta unë tërë kohën e kam e kam kaluar në arsim, dhe kam punuar si mësimdhënëse dhe kam dhënë mësim edhe në paralele serbe, në paralele shqipe, në një shkollë e cila ishte multietnike, multinacionale, multifetare dhe e ndjejsa veten sikur të isha në Bosnje. Ishte njësoj gati. Dhe në fillim të viteve të 90, ndodhi diçka për të cilën unë nuk ishte e këndshme. Edhe një ndjesi të cilën unë do tua them tash këtu, është ndjesia kur të ndjehesh e diskriminuar. Mendoj se është një ndjesi shumë e veçantë dhe në të gjitha kjo në të gjitha materialet që unë me vëmendje e kam lexuar unë nuk përmendet askund si diskriminim, diskriminim në kuptimin kur një shtet i cili nxjerr dokumentin më të lartë shtetëror dhe në bazë të tij i përkrahur nga të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë fillon diskriminimin ndaj një shtrese të re, do të thotë ndaj fëmijëve dhe mësimdhënësve të tyre dhe për këtë ekzistojnë dokumentet e përshkuara. Do të thotë ishte diskriminimi së pari në ndarjen e fëmijëve, e që unë kisha pasur dëshirë që kjo të hyjë në njërin prej këtyre dokumenteve që na i keni ofruar, që të ceket sepse është një periudhë shumë e ndjeshme dhe mos të harrojmë se krejt ata fëmijë tash janë ata të rinjtë, do të thotë janë 20 e 30 vjeçar dhe të cilët e kanë në kujtesë këtë çfarë ka ngjarë. Desha të them se kur një pushtet i jep vetes të drejtë të diskriminojë njeriun e vet ashtu si quante, çka do t'i bënte atëherë të tjerëve. Diskriminimi ishte që fëmijët të ndahen, ashtu siç u bë. Diskriminimi ishte në paga të mësimdhënësve, kur Zhivana që ishte arsimtare e anglishtes sikurse që isha edhe unë arsimtare e anglishtes e fitoi rrogën dyfish më shumë se unë dhe me listë të rrogave ishte e paraqitur ashtu dhe që kjo na solli pastaj deri te ajo që t'i themi: po e vëni lugën në pjatën tonë dhe prej sotit ne nuk do të flasim në mes veti, ashtu edhe u bë. U ndamë, krejtësisht u ndamë, secili punën e vet e shikonte. E pa këndshme, po ju ktheva pak prapa. Unë këtë e kam lënë diku në pikën më të fundit të trurit të vogël që nuk e kujtoj më. Po më erdhi rasti dhe e përmenda këtë. Dhe, pastaj, gjatë tërë këtyre viteve ju e dini se në Kosovë kemi jetuar ditë për ditë duke mos menduar për të ardhmen, duke u ballafaquar me shumë probleme. Në atë kohë prindërit e mi jetonin në Bosnje, vëllezërit e mi në Bosnje dhe unë jam ndër ata që i kam përjetuar të dy luftërat dhe se nuk kam mundur të komunikojë me prindërit e mi 5 vite, aq sa ka zgjatur lufta në Bosnje, domethënë unë e kam përjetuar atë luftë plotësisht. Dhe ajo ka qenë hera e fundit kur unë jam takuar unë me ta, sepse unë sot e atë ditë ende nuk mund të udhëtoj në Bosnje, për çka këtë edhe zonja Kandiç e përmendi. Domethënë mungon liria e lëvizjes, është e cunguar në territorin e ish-Jugosllavisë. Gjatë kohës së luftës kam qëndruar në Kosovë dhe dua të them se ndoshta kisha fat që sot jam gjallë, në atë kohë kisha një problem shëndetësor dhe isha në spital, ku unë desha s'desha duhej për mua të kujdeseshin motrat medicinale të cilat ishin serbe dhe mjekët po ashtu serbë, dhe një boshnjak. Dhe, flë sjelljes së tyre ndaj meje dhe kujdesit të tyre ndaj meje unë jam sot këtu mes jush. Pas luftës, do të thotë diku... Jo, nuk do ta përmendi këtë pjesë të pas luftës, por kam qenë shumë aktive sa i përket Kishës Katolike në kuptimin pikërisht me këtë çka po kërkohet sot këtu. Domethënë, në atë kohë, në bazë të dy letrave të lëshuara nga UNMIK-u unë isha në gjendje të udhëtoj deri në Sarajevë, sepse e kishim një

kontakt që ishte.... isha pjesë e asaj, domethënë me gratë përfaqësuese të Bashkësisë Islame dhe të Departamentit të Bashkësisë Islame dhe me gratë përfaqësuese nga Graçanica. Ato për fat të keq nuk erdhën në Sarajevë, por ato vepronin edhe më tutje në Kosovë. Domethënë ai niveli më i lartë që ishte formuar i tre komuniteteve fetare që ishim edhe këtu në Kosovë, ne ishim si udhëheqëse e tyre dhe i përfaqësonim ata dhe gratë si gra gjithmonë gjejnë tema të përbashkëta dhe unë mendoj se kjo tash po na mungon shumë që pikërisht gratë të lëvizin dhe të kanë një komunikim në mes veti. Pas një kohe, meqë atëherë ishte zoti Artemije, kryesori, zonja e cila ishte përfaqësuese e Bashkësisë Serbe Ortodokse nga Graçanica, iu pa mundësua të vijë herave tjera në takimet tona dhe ata si çift bashkëshortor ishin të detyruar që të transferohen në të vërtetë në Mitrovicë ku edhe u ndërpre në gjitha marrëdhëniet e tyre me atë grup përfaqësuesish të serbëve të Graçanicës. Tash rastësisht punoj në një vend ku shumë shpesh kam mundësi të takohem me të gjitha ato nëna të cilat i kanë humbur më të dashurit dhe që ende janë të pagjetur. Do t'i përmendi këtu dy nëna, njëra është shqiptare e tjera është serbe. Njëra thotë, po të më gjendet vetëm një asht i gishtit të vogël i birit tim dhe ta vendosi në varrin që tashmë e kanë ndërtuar për të, do të isha më e lumtura në botë. Dhe në një takim, në të cilin ka qenë prezent, kur i janë përmendur viktimat, të cilat kanë qenë të bartur prej Kosovës në Serbi, është përmendur se ka mundësi që djali i saj të jetë në atë numër, atëherë thotë, kisha ndjesi se e gjeta, e preka me dorë. Te rasti tjetër, kur një nga po ashtu, thotë: nëse atje, këtu në Kosovë, është dikush i pagjumë, ashtu siç jam edhe unë, le të lajmërohet dhe le të tregojë ku gjenden mbetjet mortore të birit tim, do ta falënderoja shumë, do t'ia dija për nder. Krejt këto dhembje e krejt këto vaje dhe i tërë ky mallkim i këtij vendi nga ana e këtyre nënave, e atyre që i kanë më të afërmit, a mendoni se do të lirohemi ndonjëherë nga kjo pa u gjetur edhe i fundit, pra edhe pa u gjetur edhe viktima e fundit. Dhe mendoj se ende jemi peng pikërisht të këtyre ofshamave dhe se të gjithë ne duhet të përpiqemi në mënyrë maksimale, aty ku jemi për çdo ditë të flasim për atë që këtyre njerëzve të cilët janë në kërkim të afërmëve të tyre të mos jetë politika ajo e cila do t'ua mbyll dyert për t'i gjetur më të afërmit e vet. Mos të jetë politika ajo që luan ping-pong, ti zhvarrose atje në Kosovë një varr e u në do ta zhvarrosi këtu në Serbi varrin tjetër, apo Bosnja me Kroacinë, apo me Serbinë, apo ku ta di unë, domethënë me bë hesape në shpinë të atyre që lotët ende nuk i ndalin. Çka mund të bëjë bashkësia fetare? Unë e di se gjatë meshës në Kishën Katolike ... janë bërë lutjet e besimtarëve dhe ne vazhdimisht lutemi për njerëzit të cilët e udhëheqin vendin, që zoti t'ua ndryshojë mendjen që të jenë sa më të drejtë dhe më të ndërgjegjshëm. Unë këtu propozoj që sot që me lutje që secila bashkësi fetare i ka në mënyrën e vet dhe gjatë shërbimeve t'ua drejtojë zotit pikërisht këtë lultje: që të shterren lotët në këto anë, të ndalohet ofshama dhe që zoti të gjithë neve të na dëgjojë mendjen që të kujtojmë se jemi këtu në shërbim të jetës, e jo të jemi këtu në zhdukjen e saj. Duke u lutur ne do të kujtojmë që gradualisht do të vijë edhe deri te falja. Falja është pika e fundit e cila është e vetmja pozitive në krejt këtë udhëtimin tonë dhe në krejt udhëtimin e KOMRA-s që do ta bënim prej ditës së parë kur është dal iniciativa për formimin e saj. Pra vetëm përmes faljes njerëzit do të lirohen. Më në fund, krishti... u thotë: ua fal zot, ua fal o atë se nuk dinë çka bëjnë. Edhe ne duhet ta themi atë: ua fal atë të gjithë atyre që kanë bërë krime se nuk kanë ditur çfarë bëjnë. Ju faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit shumë, zonja Kaçinari! Urdhëroni, ju zotëri!

Monah Nifon: Më lejoni të prezantohem, monark Nifon nga Deçani i lartë. Me mua është monarku Teodor, gjithashtu nga njëjta vëllazëri-Vëllazëria Manastirit të Deçanit të lartë i cili është momentalisht në shërbim në Prizren. Ne jemi këtu me bekimin e mitropolit Amfilohija, administratorit Dioqezës Rashkës-Prizrenit, i cili është gjithashtu anëtar i Sinodit të Shenjtë, organi më i lartë i Kishës Ortodokse Serbe. Numri ynë ketu prezent në sallë është modest, mendoj me përfaqësues të KOP sepse është pasoj e një situatë në të cilën gjendet dioqeza këto

ditë, ndoshta disa nga ju e dini ne nuk kemi peshkop të rregullt dhe kemi shume detyra të zakonshme, shumë është duke u ndërtuar, shumë është duke u rinovuar, ndihmojmë njerëzve të kthehen dhe të mbesin. Siç thuhet, të korrat janë të shumta por punë nuk ka aq shumë. Singerisht shpresojmë se në takime të ardhshme do të ketë më shumë përfaqësues tonë, dhe sigurisht ne jemi të interesuar për të mbështetur dhe marrë pjesë në këtë iniciativë të rëndësishme. Prania jonë sot këtu tregon gatishmërinë e kishës tonë dhe dioqezës të kontribuojnë në dialogun ndërmjet bashkësive fetare dhe etnike në mënyrë për të shëruar plagët e së kaluarës, të cila në të vërtetë ka shumë, që ne së bashku të gjejmë rrugën për një të ardhme më të mirë. Përfaqësuesit fetar kanë një rol të veçantë dhe përgjegjësi në procesin e ndërtimit të besimit të ndërsjellë mes të gjithë njerëzve të vullnetit të mirë. Ja falë Zotit, sot kemi dëgjuar shumë zëra të arsyeshëm në këtë drejtim. Çështja e viktimave të luftës, ne si përfaqësues fetarë nuk duhet të shikonim në përgjithësi ose të paktën jo si një çështje politike, por kryesisht si detyrë e jona fetar ndaj Zotit, dashurisë dhe drejtësisë. Feja ortodokse na mëson se çdo njeri mban në vetë personazhin e Perëndisë, dhe qasja ne ketë pune vërtetë duhet të jetë shumë e përgjegjshme. Më lejoni të citoj një pjesë si konkluzion nga stejtmenti i cili është krijuar në fund të një konference ndërfaqetare mbi bashkëjetesën paqësore dhe dialogun, që u mbajt në vitin 2006 në Patrikanën e Pejës. Po citoj: "Ne udhëheqës fetarë jemi të bindur se urrejtja dhe lufta janë një tragjedi për të gjithë, ndërsa falja dhe pajtimi shpijnë deri tek liria për të gjithë dhe për gjithkënd. Njeriu i cili urren nuk është i lirë. Liria e vërtetë e njeriut reflektohet në mardhënje me njerëzit të tjerë, pavarësisht nga përkatësia tjera etnike, feja apo besimi." Fundi citatit. Vetëm shkurtë të përkujtojë, disa përmenden që kanë qenë pjesëmarrës në konferencë, konferencë e organizuar nga Kisha Ortodokse Serbe, dhe në të ishin përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës, Kisha Katolike, Kishat Protestante dhe kështu me radhë. Ndoshta edhe disa prej jush ishin të pranishëm në konferencë, unë personalisht nuk kam qenë, pra ju e dini shumë mirë se si dukej kjo ngjarje. Kjo ishte një fillim i mirë, me sa duket, të ulen dhe të bisedojnë për bashkëjetesë paqësore, të shkëmbejnë mendime. Ishte planifikuar, për të vazhduar kësi lloji konferenca, dhe bashkësia islame e ka radhën si nikoqir në Prishtinë. Për fat të keq, disa situata të përditshme, problemet, ne të gjithë e dimë se sa të ndjeshme janë, kohë pas neve, në çdo kuptim, dhe kjo e pengoi mbajtjen e konferencës së rrallë. Megjithatë ne shpresojmë që në të ardhmen ky dialog ndoshta, këtu, të them tani e kemi përkujtuar më këtë mbledhje të sotme dhe që është detyrë dhe obligim i yni përsëri të ulemi në të njëjtën tryezë për të diskutuar rreth këto çështje të rëndësishme. Të kthehem pak ... Unë këtu e bëra një përkujtim. Pra, zoti na mëson për dashurinë ndaj afërmve si ndaj vetes, dashuria ndaj Perëndisë pasqyron dashurinë ndaj afërmve. Nuk ka dashuri për Perëndinë, pa dashuri ndaj njerëzimit apo e kundërta. Mësoi i madhërishmi Justin Popović. Një çështje shumë e rëndësishme, e përmendur disa herë sot, dhe ne duhet të theksojmë është problemi i personave të zhdukur. Kjo është një çështje veçanërisht e dhimbshme në historinë tonë të re, dhe personat e zhdukura janë të gjitha nacionaliteteve. Si Kisha Ortodokse Serbe mendojmë që është shumë e rëndësishme për të bërë çdo përpjekje, për të gjetur një mënyrë për të ditur fatin e tyre. Sa për çështjen e fajit, një konflikt civil nuk mund të shikohet si një çështje e përgjegjësisë kolektive. Përgjegjësia duhet të jetë individuale, dhe detyra i takon organeve hetimore ose gjykatës. Gjithashtu, as pendimi apo falja nuk mund të jetë kolektive. Këtë duhet për të bërë çdo njeri në zemrën e tij, pas këtë dhe për të thënë. Ne si kishë dhe bashkësi fetare kemi rolin e thirrjes në pendim të brendshëm dhe duke marrë në pyetje të gjithë të saj ... para ndërgjegjes dhe para Perëndisë. Kjo është detyra dhe kontributi ynë më e madh. Gjithashtu duhet kaluar prej fjalëve në vepra, veprimet flasin më shumë se një mijë fjalë. Manastiri i Deçanit në këtë drejtim në mënyrë aktive tregoi mospajtim më çdo lloj dhune, jo vetëm me fjalë, por me vepra konkrete, nga koha kur manastiret strehonin refugjatët gjatë konfliktit. Këta ishin jo vetëm

refugjatë serb por edhe shqiptarët dhe romët. Gjatë vizitës së tij të fundit presidenti amerikan Jon Baiden veçanërisht duke përmendur rolin e manastirit tonë dhe kishës tonë ka dhënë në një farë mënyre, njohjen ndërkombëtare të pozicionit tonë parimor mbi dhunën, si një mënyrë të gabuar, një përpjekje për të trajtuar të gjitha problemet. Kisha jonë shpesh herë i ka dënuar të gjitha llojet e dhunës, pavarësisht cila anë e ka kryer dhunën. Ne sot nuk jemi këtu për të folur për politikë, për territorin, në lidhje me historinë. Është më të vërtetë temë e gjerë, gjatë dhe thellë. Më duket se kjo nuk do të na shpie askund. Gjithashtu kjo nuk duhet të jetë mbledhje në të cilën do të paraqesim akuzat. Kemi pasur mjaft akuza në të kaluarën. Shkrimi i shenjtë evangjelic thotë: Nxirre traun nga syri yt, pastaj do të sheh të nxirresh theren nga syri i vëllait tënd. Pra, nëse duhet të flasim për përgjegjësi duhet filluar nga vetja, dhe mos të drejtojmë me gishtin në të tjerë, sepse duke akuzuar të tjerët para se të merremi më të metat tona, shkak kryesor të urrejtjes dhe konfliktit. Gjithashtu, më duket se është ende herët për të marrur me raste konkrete. Më rëndësi është që jemi mbledhur dhe jemi ulur për të biseduar së bashku, për tu njoftuar, shprehur opinionet, disa propozimet, për çka na ftoi zonja Kandic, por ne nuk mundemi të zgjedhim problemin i cili zgjat një kohë të gjatë në tërësi. Është një punë e madhe para nesh. Sigurisht, që çdo kush prej nesh mund të përmend shumë shembuj të pësuarve të tyre. Kjo do të diskutohet me kohë. Tani mos të përsëris, ka pasur disa vende, ku mua më duket se Kisha Ortodokse Serbe, dhe ne këtu të cilët e përfaqësojmë jemi të ftuar për të dhënë një replikë, nuk mundemi në të gjitha, por ja disa, disa i kam shkruar këtu duke u përpjekje për të mbajtur në mend. Me falni! Mbi të gjitha ato brohoritje të turpshme në Gazimestan të cilat u dëgjuan, të cilat i përmendi zotëri imami nga Rahoveci, me të vërtetë janë të turpshme për ne. Mendimi im personal, gjithashtu mund të flas dhe në emër të kishës, sepse për këtë biseduam dhe në manastir kur kemi dëgjuar dhe kur i pamë ato pamje, disa kanë qenë aty të pranishëm. Djemtë që brohoritnin ato fjalë mendojnë se shërbejnë komunitetit serb, por ata nuk i shërbejnë, për kundrazi ata e pengojnë dhe mendojnë se janë anëtarë të kishës, ata mendojnë janë duke i ndihmuar Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë por kurrsesi në atë mënyrë nuk i ndihmojnë vetëm i reflektojnë një dritë shumë të keqe. Sipas mendimit tim personal, unë nuk i njoh këta njerëz, natyrisht, por sipas mendimit tim personal se ata nuk janë anëtarë të kishës, mund të janë të pagëzuar, por nuk jetojnë jetë aktive të kishës, nuk janë besimtarë, ndoshta dëshirojnë të lavdërohen, por në të vërtetë nuk e kuptojnë konceptin e besimit dhe të shërbimit ndaj Zotit dhe njerëzve. Ata janë thjesht njerëz të rinj më plot pasion dhe urrejtje. Por unë sot këtu, e ftoj z. imamin nga Rahoveci dhe të tjerët, që të jemi pakës më të fort. Në ç'kuptim? Një kohë e vështirë është pas neve, kanë ndodhur gjera të shëmtuar. Duhemi të jemi pak sa të përgatitur për të duruar ndonjë fjalë, për të duruar ndonjë situatë. Nuk munden të gjithat më qenë të përkryera, nga sot, nuk e di të ulemi dhe të arrijmë një marrëveshje dhe së të gjithat do të shkojnë ashtu. Nuk duhet të durojmë se këta të tjerët i nuk do të duhen, nuk do të na drejtojnë vetëm fjalë lavdëruese. Qe, unë mund të ftoj imamin për të ardhur një ditë tek ne në Deçan... Mund të dëgjoni diçka të ngjashme çdo ditë, çka na brohorasin fqinjët tanë. Këto fjalë nuk janë të këndshme. Edhe këtu në Prizren, ku kemi dëshirë për të shëtitur dhe shpesh vijmë, tani është ati ynë, Teodori këtu dhe gjithmonë ndodh që dikush na ofron ndonjë përshëndetje dhe kështu me radhë. Pra, neve kjo nuk na fye, thjeshtë e durojmë, e dimë se çfarë është detyra jonë, ne jemi përfaqësues të kishës, bashkësive fetare, këtu jemi për të predikuar dashuri, optimizëm, kërkimit të së vërtetës, kështu që ja shihni, çdo situatë nuk mund të jetë e këndshme, por shpresojë se sadopak kam arritur që imamit ti them se këto brohoritje në Gazimestan kurrsesi nuk janë diçka që kisha ortodokse serbe i ka përshëndetur. Pra, kjo ishte ajo. Të shoh a ka edhe diçka tjetër ... Po, u përmenden disa fakte historike, ngjarje. U përmend që serbët shkuan në territore të tjera për të vlarë, në Serbi nuk pati pësime, nuk pati viktima. Kjo nuk është e vërtetë! Larg nga ajo! Unë sot nuk do të flas për atë detajuar. Doja

vetëm një tjetër t'ju kujtoj se duhet të jemi të vetëdijshëm se z. imami e përmendi definicionin e viktimës. Sa përket neve, viktimë, sot, në kontekst në të cilin jemi duke folur, viktimë është ai që pëson, pavarësisht nga përkatësia etnike ose fetare, dhe kriminel është ai që e ka kryer krimin. Dhe ne duhet të jetë krejtësisht të fortë dhe të fuqishëm për të pranuar atë. Ne këtu nuk jemi këtu për të përfaqësuar ndonjë shtet ose opsjon politike, por për të përfaqësuar diçka që duhet të jetë mbi këto koncepte dhe mendoj së lidhur më këtë duhet të kemi një kuptim dhe unitetin të përbashkët. Edhe një herë e përsëritës këtë iniciativë, siç e bëri në emër tone dhe Patrikanën në Beograd i ati Vukasin Milicevic. Kënaqësia është e imja që ne sot jemi këtu së bashku, në Prizren, në qytet i cili simbolikisht përshkruan llojshmërinë fetare, shpirtërore dhe kulturore. Ju falënderojmë organizatorëve për nisjen e kësaj iniciative të rëndësishme dhe ne sigurisht që do të përpiqemi për të dhënë mbështetjen tonë në të gjitha vazhdimësi konkrete të këtij projekti. Ju falënderoj!

Bekim Blakaj: Faleminderit! A dëshiron ndokush tjetër fjalën? Po, urdhëroni, zotëri!

Liridon Kadriu: Së pari, ju përsëritës! Përsëritës mbi të gjitha, zonjën Kandiç e cila ka një respekt të madh ndër ne shqiptarët, organizatorët, komunitetet fetare, përfaqësuesen e Ambasadës Zvicrane, profersorë të nderuar dhe të gjithë panelistët e pranishëm.

Unë jam Liridon Kadriu, orijentalist dhe gazetar i pavarur. Njëkohësisht po ua tregoj edhe një drejtim timin personal, pasi që edhe ne të gjithë të cilët jemi këtu të pranishëm kemi nga një përjetim dhe të gjithë në një formë apo tjetër jemi edhe viktimë të luftërave, të luftës, e dikush të luftërave të ndryshme të cilat ndodhën në territoret e ish-Jugosllavisë.

Në vitin 1999 në fshatin Dyz të Podujevës mu para syve të mi më është vrarë daja dhe djali i dajës. Dhe me të vërtetë ko ishte një torturë psikologjike ndaj meje dhe edhe sot e mbaj të freskët këtë tregim dhe ngjarje të dhembshme e cila më ka ndodhur mua.

Pas përfundimit të luftës dhe pas kthimit që patëm në Prishtinë, është e vërtetë se grupet e frsutraura, bashkëkombasit e mi shqiptarë kanë vrarë disa serbë të pafajshëm, mirëpo është e vërtetë se këto grupe ishin disa grupe të frsutraluara dhe grupe të cilat nuk kishin asnjëfarë komande, mirëpo ishin thjeshtë kriminelë të ndryshëm të cilët për përfitime të ndryshme materiale i bënë këto gjëra. Dihet mirëfilli se shkaktojnë e këtyre tri luftërave në ish-Jugosllavi është politika gjenocidiale e Serbisë dhe viktimë është viktimë, është e vërtetë mirëpo prapëseprapë mendoj se viktimat në një formë apo në formë tjetër nuk mund të barazohen, sepse shkaktojnë e të gjitha këtyre luftërave dhe gjithë këtyre viktimave është politika e Millosheviqit nga e cila u pësua shumë dhe janë vrarë, masakruar shumë viktimë të ndryshme dhe më pastaj përveç shqiptarëve, boshnjakëve dhe të tjerëve pësoi edhe vetë populli serb dhe është duke pësuar dhe duke vuajtur ende këto plagë. Unë do të rekomandoja që para fillimit të kërkimit faljeve të ndryshme që Kisha Ortodokse Serbe të distancohet nga politika e kaluar. Dhe më pëlqeu jashtëzakonisht fjalimi i përfaqësuesit të Kishës Ortodokse Serbe që mbajti këtu dhe do të isha i lumtur që njësoj me këtë gjuhë të fliste edhe ish patriku Pavle e tash edhe patriku Irinej. Po fatkeqësisht, kjo nuk po ndodhë. Por, mesazhi i përfaqësuesit të Kishës Ortodokse Serbe besoj se jep një mesazh se edhe Kisha Ortodokse Serbe ka filluar që të diskutojë këto gjëra në vetë klerikë e saj dhe ka filluar që edhe të përmirësohet dhe të bëjë edhe reforma. Unë do të jap edhe një rekomandim që në llojet e shkeljeve të cilat janë përcaktuar këtu te mandati i KOMRA-s që të vihej patjetër edhe tortura psikologjike që kanë pësuar viktimat e ndryshme në luftëra të ndryshme. Pasi që u përmend edhe më herët që tentohet të mblidhen 1 milionë nënshkrime besoj se këto 1 milionë nënshkrime duhet që t'i dorëzohen parlamentit serb i cili do të nxjerrë një ligj që t'u bëjë kërkim falje të gjitha viktimave pa marrë parasysh nacinalitetin dhe përkatësinë e tyre fetre dhe në ligj të përshkruhet edhe dëmi që duhet t'u shpaguehet këtyre viktimave. Prandaj, KOMRA përveç mbledhjes së fakteve që duhet ta bëjë dhe më pëlqen ky fakt se thuhet që mos të

luhet më me numra se janë mbytur kaq e aq, mirëpo të kenë shifra adekuate dhe shifra të evidentuara se sa ka viktima në cilëndo qoftë palë. Dhe si përfundim, do të kisha një pyetje për përfaqësuesin e Kishës Ortodokse Serbe se kur Kisha Ortodokse do të distancohet plotësisht nga politika e kaluar gjenocidale. Ju faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit! Po, unë nuk besoj se ky është vend i duhur për të parashtruar këso pyetje. Ne sigurisht sot nuk jemi duke folur fare për këtë. Megjithatë, dua me cek vetëm një çështje, ju ishit i vetmi sot këtu që u futët edhe në mandat për punën e ardhshme të komisionit, që u futët kjo edhe si shkelje edhe tortura psikologjike. Unë personalisht kam mendimin tim që atëherë komisioni do t'i kryejë dhjetë vjet së paku, kështu që sidoqoftë nuk është koha për këto çështje. Ndërsa, sa i përket edhe kësaj 1 milionë nënshkrimeve, në fakt ideja për mbledhjen e 1 milionë nënshkrimeve ka të bëjë në fuqizimin e kësaj nisme dhe ato nënshkrime do t'i deponohen jo vetëm Qeverisë së Serbisë por të gjitha qeverive, jo me kërkesë për kërkim falje por me kërkesë që të themelohet ky komision, siç u shpreh sot në mëngjes zonja Kandiç që ky të bëhet një projekt ndërshtetëror. Domethënë, ky është qëllimi i mbledhjes së këtyre 1 milionë nënshkrimeve. Zonja Kandiç e ka fjalën!

Nataša Kandić: Unë dua të jap vetëm dy shpjegime. Kur prifti Nifon foli rreth përgjegjësive. Në kuptim juridik dhe politik, sidomos në juridik ekziston fajësia individuale, por kur është fjala për përgjegjësi atëherë ka një përgjegjësi kolektive. Kjo është përgjegjësia politike, kjo është një përgjegjësi qytetare, kjo është një përgjegjësi morale, por nuk ekziston fajësia kolektive. E dyta kur bëhet fjalë për viktima sipas kombësie, të gjithë e dimë dhe askush nuk mund ta ndryshojë këtë. Ne vetëm duam që shifrat të zëvendësohen më emra sepse numrat pa emra janë fyerje për viktimitë, ata të cilët nuk janë më në mesin tonë kjo është diçka që duhet të individualizohet dhe në këtë drejtim ka dallime të mëdha. Do të kemi emrat e atyre që pësuan si viktima të krimeve të luftës, për shembull, në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, ata që u vranë në Kosovë dhe kjo është diçka e pashmangshme, ekzistojnë dallime në përkatësinë etnike. Ne si organizata jo-qeveritare kemi bërë shumë në individualizim dhe identifikim të viktimitave dhe deri tani ne kemi një numër, të themi, 13.500 të vrarë si viktima të krimeve të luftës, që vdiqën dhe që janë zhdukur në Kosovë. Në këtë numër rreth 10.500 njerëz janë kombësisë shqiptare, që do të thotë shumica e viktimitave të krimeve të luftës dhe kjo është diçka si një fakt e diçka tjetër është kur bëhet fjala për të vërtetën. E vërteta e tij, kur pa vrasjen e xhaxhait të tij dhe djalin e tij në Kosovë, në Podujevë, ose disa vërteta të tjera. Të vërtetat individuale janë të tmerrshme. Ne mund të kemi bashkëndjenje, plotkuptimë, të na vjen tmerrsisht keq, të përpiqemi të imagjinojmë atë, por ne nuk mundemi plotësisht të qëndrojmë në rolin e atyre të cilët e përjetuan drejtpërdrejtë. Ne mund të kemi shumë respekt ndaj nënës e cila e ka humbur djalin, por atë dhimbje thjesht nuk mundemi ta pranojmë plotësisht. Ne vetëm mund të bashkëndijmë, por ajo dhimbje individuale, një e vërtetë individuale është diçka që çdo individ e mban në vete, dhe tani pjekurshmëria dhe pranimi i përgjegjësive, e përfshin dhe shprehjen e vazhdueshme të solidariteti, bashkëndjenje dhe respekti.

Bekim Blakaj: Meqenëse sipas programit i kemi edhe 7 minuta, zotëriu e ka kërkuar fjalën dhe lus të prezantoheni.

Frok Kristaj: Unë jam Frok Kristaj, shqiptar për nga nacionaliteti. Unë jam katolik, me profesion gazetar. Pasi që kam dëgjuar krejt këto sot çka u fol, së pari do të them diçka në mënyrë telegrafike disa fjalë. Pra, pasi që kam dëgjuar të gjitha këto sot, unë shoh se ekziston nevoja t'i afrohem njëri tjetrit me një marrëdhënie të re. Në ne, pa dallim, është shtresuar e keqja dhe kemi shumë robëri shpirtërore që të gjithë. Ndaj, mendoj se duhet t'i rrefehemi vetëvetes para se gjithash në mënyrë që ta pranojmë tjetrin. Nëse nuk i rrefehemi mirë vetëvetes besoj se nuk do të jemi në gjendje t'i afrohem njëri-tjetrit. Fundja, NATO-ja ndërhyri në Kosovë dhe ne u çliruam,

por nuk ka „nato“ që ndërhyt në ne që të çlirohemi nga vetëvetja. Kjo është për mua rreziku më i madh sepse ende kemi të keqe të shtresuar në vetëvete për t'iu afruar njëri-tjetrit.

Përndryshe, megjithatë, në fakt konsideroj se nuk do të mund të afrohem pa dëgjuar përmes nesh zërin e të pagjeturve. Ajo është dhimbja jonë më e madhe, e jonë kur e them, është e të gjithë atyre që jetojnë në këtë troll këtu, të kujdoqofshin të pagjeturit, është dhimbje individuale por është edhe dhimbje kolektive. Vetëm kur e dëgjojmë zërin e tyre përmes nesh ne mund të ulemi shumë afër njëri-tjetrit dhe mund t'i definojmë shumë gjërat më tepër në mes veti. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit shumë, zotëri Frok Kristaj! E patë, edhe pse nuk kemi dashtë sot me ju ngarkuar me çështjen e statutit – draftstatutin, megjithatë jemi të gjithë këtu dhe nëse e shihni do të thotë qëllimet e komisionit rajonal janë dhe ndër ato kryesore që të ndikohet është edhe çështja e identifikimit të gjithë personave të zhdukur. Sot e patëm rastin të shohim filmin e shkurtër dokumentar në lidhje me komisionin e Marokos, përndryshe komisioni i Marokos njihet si një ndër komisionet i cili suksesin më të madh e ka pas në gjetjen e mbetjeve mortore të cilat kanë qenë nëpër varrezat masive. Shpresoj se edhe KOMRA do të ketë një sukses të tillë dhe numri të cilin e përmendi Natasha në mes 16.000 dhe 17.000 të zhdukurve së paku të zvogëlohet në mënyrë drastike. A dëshiron edhe dikush fjalën para se ta përmbyllim këtë takim, sepse po e shoh, edhe dreka ka filluar të shtrohet. Po, nëse keni mundësi, shkurtimisht pa replika ose ndonjë pyetje.

Nysret Abazibra: Po, shumë shkurt, s'ka replikë, veç desha ta falënderoj përfaqësuesin e manastirit. Besoj se kjo frymë e deklaratave të tilla, nëse përhapet edhe te përfaqësuesit tjerë të kishave ortodokse do të sjell shumë përparime në vendin tonë në këtë drejtim. Prandaj, e falënderoj për këtë deklaratën që e dha më herët.

Bekim Blakaj: Faleminderit edhe një herë! Ju keni pyetje? Urdhëroni!

Ramadan Shkodra: Desha me i ra shkurt dhe më konkret! E kam një pyetje për ju dhe zonjën Kandiç! Çka mundemi ne konkretisht me ndihmuar në këtë drejtim. Po them kështu në mënyrë më të sinqertë, mos t'i bëjmë lajka njëri-tjetrit, e mos të përshëndetemi e më the e të thash, por ka mundur konkretisht të bëjmë dhe po bëhem shumë i sinqertë nuk e di as agjendën të cilën e keni ju, dhe çka munden këta priftët e kishës ortodokse, të asaj katolike, përfaqësuesit e bashkësisë islame dhe tjerët, që dihen çfarë janë gjërat konkrete, dhe jo krejt gjëra teorike. Ai zotëriu atje tha pak më parë, e kam një rrëfim. Çka do të bëhet me atë rrëfim, a do të shqyrtohet, a do të publikohet a s'do të publikohet, a do të merrete apo s'do të merret. Unë thash se do të ketë rrëfime të shumta, por së pari cili është qëllimi i krejt kësaj. Unë po them, si gazetar, kam përcjell shumë këso takime dhe kjo iniciativë mos të përfundojë si iniciativa tjera, të marrin një rrugë dhe të mbeten diku të pa kryera. Unë besoj se edhe profesor Hasani pajtohet me mua, se jemi tash dhjetë vejt pas konfliktit në Kosovë, jemi shumë më të relaksuar, të gjitha gjërat kanë ndryshuar, kemi realitet tjetër. Çka mund të bëjmë, pyes zonjën Kandiç, konkretisht. Nëse keni ndonjë udhëzim dhe me 20-30 vetë dhe nëse e bëjmë secili nga një punë bëhen 30 punë, po nga 10 bëjmë 300, pra konkret diçka të dimë. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit shumë për pyetjen, zotëri Shkodra. Edhe pse edhe kolegu juaj kyeimami e përmendi që Bashkësia islame kishte me i ndihmuar shumë viktimave në përkrahje që të japin dëshminë e tyre para komisionit e kështu me radhë. Mirëpo, parësisht, mendoj se neve na duhet përkrahja juaj, ju me na përkrah dhe besoj, se kur ishim në takim me muftiun e nderuar, ai na tha ne kemi zë shumë të madh, një të premtë në xhami me u predikua, me u përmend, ju do ta keni përkrahjen shumë më të madhe, domethënë tek popullata. Unë besoj se edhe zonja Natasha ka diçka, ka përgjigje për juve.

Nataša Kandić: Sigurisht, pyetja juaj është pyetje në vend. Është mirë të kemi mbështetje, por si konkretisht të ndihmuar. Së pari duhet të them se ne kemi pasur frikë të madhe për të hyrë në këto

takime me bashkësitë fetare. Thjesht, ne ishim të pasigurt se çfarë reagimi do të ketë. Ne vërtetë kemi qenë të inkurajuar, veçanërisht me takimin e mbajtur në Serbi. Sa për këtë Kroacisë, ne e kishim të qartë se Franjevcat kanë për të na mbështetur. Në Beograd, kam dëgjuar një sugjerim të cilin unë shumë shpesh e përmendi. Ka pasur sugjerime që kisha të fillojnë të organizojnë takime lutje për viktimë. Dhe pastaj ne e kemi lënë tashmë pas pushimeve të fillojmë me këto takime që në fakt të pyesim përfaqësues të kishave dhe komuniteteve fetare se si ata mendojnë për ta arritur këtë. Pastaj një tjetër propozim që erdhi nga organizatat civile që roli i bashkësive fetare në avokim të nismës ndaj politikanëve mund të ndihmon shumë. Konkretisht ne menduam kur të fillojmë me takime me politikanë që nuk do të ketë grupe të mëdha me shume se 5-6 persona, por për të lutur përfaqësues të komuniteteve fetare për t'u ... në çdo vend do të jetë grupi rajonal që do të shkojë, dhe kur të shkojmë të presidentit Ivo Josipoviç në Kroaci që në këtë grup të përfshihen disa njerëz nga përfaqësues të kishave, bashkësive fetare, të dakordohem për këtë, mos të kuptohet se nga secili komunitet fetare duhet të jetë një përfaqësues, sepse kjo do të jetë pastaj një grup i madh, sikur që nuk do të jetë ndonjë nga grupi që morën pjesë në bisedimet, ne nuk do të bëjmë grupe prej 50 veta por më pak në mënyrë që të marrim mbështetjen politike publike. Pra, deri tani ekzistojnë këto dy nisme, takimet e lutjes dhe përfshirjen e përfaqësuesve të komuniteteve fetare në marrjen e mbështetjes politike dhe pastaj menduam parimisht për të bërë fushatë për mbledhjen e nënshkrimeve dhe mendojmë se bashkësitë fetare mund të ndihmojnë shumë në atë, ne tani jemi duke u përpjekur të mendojmë se si do të ec kjo, nuk është lehtë për të mbledhur një milion nënshkrime. Unë nuk e di, në të vërtetë, për shembull Sllovenin, nuk e kemi bashkuar ende Maqedoninë, Slloveninë, por ende nuk e kemi. Cila është një çështje tjetër e rëndësishme. Ne sot nuk kemi biseduar me juve për statut. Ju të gjithë e keni marr, ky është një dokument i rëndësishëm. Objektivat e komisionit janë shumë të rëndësishëm. Deri në shtator do të bëjmë një veb faqe për forum- por nuk jemi të sigurt se të gjithë kanë qasje në internet dhe së ata në këtë mënyrë do të marrin pjesë. Ne dëshirojmë të marrin pjesë dhe në këto konsultime rajonale me bashkësitë fetare që do të organizohen në Bosnje-Hercegovinë, në qytetin Fojnica. Para së gjithash do të mundohemi që pjesëmarrësit nga Kosova mund të vijnë me dokumente të Kosovës, por që do të thotë se do të ketë dhe kjo pjesë informative, do të bisedohet për statut, qëllimet, objektivat, dhe mënyrën e përzgjedhjes anëtarëve të komisionit. Ju e dini se ky është një komision rajonal. Deri tani, ka pasur shumë kundërshtime me një propozim i cili thotë se anëtarët duhen të kenë diplomë universitare. Veçanërisht protestuan shoqatat e viktimave cilat than kështu diskualifikohet shumica e atyre të cilët duhen të jenë anëtarë të KOMRA-s. Do të thotë ky është një rol i tretë në të cilën ju duhet të jeni, e kjo është se ju duhet të ndihmoni për të bërë statutin sipas rregullave cilat neve na nevojiten për shkak të kaluarës dhe të ardhmes. Përveç kësaj, ju po e shihni dhe vetë se shumica kanë ardhur dhe janë larguar. Kjo nuk është një çështje ende për mediat. Nuk është interesante. Sot, ata nuk patën informacion a është ky komision apo koalicioni, kështu që ky nuk është një lajm i madh. Ne tani kemi hyrë në fushatë mediale me video spot cilin sot e shfaqem dhe kjo është gjëja e parë që e kemi marrë është në fakt hera e parë që ka ndodhur në Serbi ku mund të dëgjohet në të njëjtin vend zëri ne gjuhen shqipe, zëri nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia dhe këtu në Kosovë për të dëgjuar zëri në gjuhen Serbe. Të gjithë pranuan që spoti rajonal është shumë i mirë, që do të thotë se kemi pasur sukses në hapin e parë. Tani shkojmë më përvetësimin e mediave, politikanët, dhe nuk është lehtë. Në Bosnjë dhe Hercegovinë duhet të presim deri në fund të zgjidhjeve, deri në nëntor ndërsa në vendet të tjera në fakt mund të fillojmë. Këtu është një tjetër çështje shumë e komplikuar, të cilën ende nuk e kemi zgjidhur, por duhet për të zgjidhur. Ne kërkojmë që kjo nismë të bëhet një projekt shtetëror. Kjo do të thotë, se shtetet e formojnë komisionin e jo komuniteti fetar, jo shoqatat, jo OJQ-të sepse ky komision duhet të ketë pushtet, që ka fuqi për të thirrur individët dhe përfaqësuesit e

institucioneve për të dëshmuar para komisionit. Fuqinë e komisionit e vulos shteti. Ju të gjithë e dimë se kemi marrëdhënie në mes të Serbisë dhe Kosovës, në mes të Bosnje-Hercegovinës dhe Kosovës, dhe ne mendojmë se ky komision mund të ndihmojë në zgjidhjen e çështjes. Pra, duhet për të gjetur mënyrën dhe kjo duhet të jetë një mënyrë ligjore që të gjithë trashëgimtarët e ish-Jugosllavisë, së bashku bien vendimin për formimin e këtij komisioni. Kjo është një çështje serioze që kërkon zgjidhje ligjore dhe politike. Kështu, deri në dhjetor, me 10 dhjetor, ne kemi për detyrë të gjejmë zgjidhje, dhe mendoj natyrisht që ky komision mund vetëm gjen zgjedhje pikërisht në këtë pikë ku ne nuk kemi ... por ka shumë pjesëmarrës të cilët seriozisht merren me këtë dhe jam plotësisht e sigurt që do të kemi zgjidhje dhe se kjo zgjidhje do të ndihmojë në normalizimin e marrëdhënieve shoqërore, politike dhe të përgjithshme sociale në rajon, veçanërisht Serbisë, Kosovës, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kroacisë.

Bekim Blakaj: Hvala Nataša! Nuk e di a ka edhe dikush diçka të shtojë? Zonja Kaçinari? Në përfundim jemi, nëse keni diçka, urdhëroni!

Greta Kaçinari: Unë e kam një propozim tash së fundi, pasi për fat të keq u desh në fillim por nuk munda, dhe meqë këtu janë edhe përfaqësuesit e bashkësive fetare dhe e para ide ishte se secili është fetar në vetevete, do të thotë beson te zoti dhe do të kisha dëshirë të propozoj lutjen që zoti të na ndihmojë të gjithë neve në gjithë vendin dhe që ky takim të ketë sukses. Pasi unë nuk munda ta realizoj këtë mendim në fillim, unë proozoj që tash në fund të këtij takimi për një minutë secili në vetevete të lutet te zoti për këtë ëtakim dhe t'i bekoj takimet tjera të ardhshme kudo që mbahen për shkak se këto iniciativa kështu pozitive duhet të jenë të përkrahura. Prandaj, do të ishte mirë që për një minutë ta bëjë në vete këtë lutje te zoti. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Në rregul, po pajtohemi për këtë! Urdhëroni edhe ju!

Ajni Sinani: Shikoni, mendim im personal është ky. Unë mendoj se zonja Kandiç me ju mund të ketë sukses në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Kroaci por unë dyshoj se mund të ketë sukses brenda Serbisë. Pra, nuk e di çfarë mund të bëjë brenda Serbisë se sikur që e dimë të gjitha këto janë të gjitha të këqijat këtu që kanë ndodhur ka qenë Serbia – qeveria e Serbisë, ish qeveria por po shoh se edhe kjo qeveri nuk po vepron sa duhet. Prandaj kisha dashur të di ku jemi lidhur me këtë, me dy tri fjalë me na treguar.

Bekim Blakaj: Natasha, urdhëroni!

Nataša Kandić: Pra, e thash edhe më parë se konsultimet më të suksesshme fetare deri tani kanë qenë në Serbi. Kjo ishte një befasi e papritur. E përmenda se sa frik kemi pasur. Pastaj e kemi mbështetjen e shoqatës së serbëve nga Kosova, shoqatave të viktimave serbe, shoqatave të viktimave nga Kroacia. Të gjithë ata e shohin iniciativën si tmerrësisht të rëndësishme për viktima, për anëtarët e familjes të viktimës, sepse ata janë të vetëdijshëm për këtë fakt që deri tani, pas 19 apo 11 vite fati i të personave pagjetur apo përcaktimi fakteve për të vrarë, të pësuar dhe të zhdukur çka ishte deshtë për të bërë nuk është bërë. Pra, të gjithë ata që janë prekur nga lufta kanë një tragjedi personale të tyre, ato shumë mirë dallojnë se çfarë është në interesin e tyre. Sinqerisht unë mendoj se nuk do të ketë politikanë që do të guxon të thotë se ai është kundër ... Faktet janë diçka që të gjithë duhet për të pranuar Kjo është kushtet për një të ardhme. Të gjithë në territorin e ish-Jugosllavisë dëshirojnë integrim evropian, dëshirojnë Bashkimin Evropian. Pa fakte nuk ka integrim evropian, nuk ka bashkëpunim rajonal. Ne të gjithë e kuptojmë se bashkëpunimi rajonal është një kusht të integritimit evropian. Që marrëdhënie të mira fqinjësore janë kusht për proces të stabilizimit dhe asociacionit. Prandaj hapi tjetër dhe kërkesa nga bashkësia ndërkombëtare të cilin këtu është duke e ngritur është krijimi i bashkëpunimit dhe komunikimit rajonal, marrëdhënieve të mira fqinjësore të cilat më të vërtetë do të dinë të përfshijnë një zërë në bisedime zyrtare dhe zëri cili duhet të krijohet në çdo komunitet. Mendoj se kjo është një ndryshim shumë i rëndësishëm dhe unë mendoj se politikanët ngadalë detyrës së

re. Do të thotë normalizimi i marrëdhënieve të cilat duhen të çojnë tek formimi i një shoqërie të mirë në këtë rajon. Pa këtë nuk ka ndjenjë të mirë për familjet e viktimave. Nëse ne nuk fillojmë të kultivojmë një gjuhë të mirë për ndonjë viktimë as familjet nuk do të ndihen më mirë. Unë sot jam shumë, shumë mirënjohës për këto fjalë të Kishës Ortodokse Serbe, sepse fliste më një gjuhë shumë, shumë të sjellshëm ishte kënaqësi për t'u dëgjuar dhe kjo është e rëndësishme që ne më në fund kemi një gjuhë të re. Të gjithë kemi shumë nevojë për këtë dhe mendoj se mund të gjejmë në Serbi. Ne kishim diçka në Serbi në atë ... nuk ishte shumë kohë më parë, me datën 16 qershor. 16 bashkëngjitje e atyre që ishin nga radhët e komuniteteve fetare. 16 prej tyre ju bashkëngjiten koalicionit për formimin e KOMRA-s. Prifti i përmendur Vukašin ai nuk kishte asnjë të drejtë për të nënshkruar deklaratën për bashkëngjitje në emër të Kishës ortodokse serbe, sepse ka një hierarki dhe rregulla dhe ai u nënshkrua në emër të tij personal dhe ai është anëtar i një koalicionit për KOMRA dhe natyrisht kur kemi ndonjë takim në nivel rajonal, ne do të jemi të detyruar të ftojme dhe atë.

Bekim Blakaj: Hvala Nataša! Izvolite!

Murgu Nifon: Kërkoj falje, e di që jeni të gjithë të lodhur, vetëm shkurtimisht desha për tu drejtuar zotëri Sinanit, cili është i brengosur a do të ketë komisioni sukses në Serbi dhe deklaroi që nuk ka gjasa që kjo të kalojë në Serbi. Desha vetëm ta përkujtoj por edhe neve të pranishëm, sepse duke e respektuar brengosjen e tij mendoj se me shqetësim asgjë nuk mund të bënë lidhur më atë se çka do të ndodhë me komision, a do të ketë sukses në Serbi apo jo. As unë nuk mund të bëjë asgjë në lidhje me këtë a do të ketë komisioni mbështetjen qeveritare në Serbi apo jo. Mendoj që secili.... a do të pendoheni dhe ju. Unë mundem të kujdesem për veten time dhe për ata të cilët i kam breng. Pra, eja edhe njëherë për të vënë këtë gjë, dhe të gjithë të nisemi nga iniciativa ndoshta do të ketë ndonjë shans për sukses. Përndryshe, përsëri do të akuzohemi dhe kështu më radhë. Më falni që ju mora kohën.

Bekim Blakaj: Faleminderit! Ne veç e kemi tejkaluar kohën. Kisha pasur dëshirë që ta përmbyllim takimin.

Ajni Sinani: Mirëpo sot po shihet, dhe ne kemi me qenë viktimë, prandaj edhe e bëra këtë pyetje, dhe me shqetësim, sepse edhe sot e kësaj dite Serbia ka pretendime territoriale ndaj Kosovës. Këtë e di e gjithë bota. Ju po doni të reformoni komisionet me bashkësitë fetare dhe nga vetë shtetit, shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë. E dimë fort mirë se çfarë qëndrimi ka qeveria serbe ndaj Kosovës. Këtë desha të them. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit edhe një herë! Unë kisha thënë më shumë ne koalicioni, organizatat joqeveritare shpresoj që do të ju kemi edhe juve si bashkësi fetare në këtë koalicion dhe do t'i shtyjme qeveritë që ta formojnë këtë komision. Jo ata me vetë dëshirë, mirëpo me një presion të tillë prej bashkësive fetare, organizatave joqeveritare ndoshta edhe bashkësia ndërkombëtare, unë mendoj që ata do të jenë të shtyrë që ta krijojnë një komision të tillë.

Edhe një herë dua të ju falënderoj shumë për pjesëmarrjen tuaj. Dua ta falënderoj posaçërisht profesorin Hasani, zonjën Kandiç, Vetonin dhe të gjithë juve. Një falënderim dua me ua bë edhe përkthyesve që kanë përkthyer sot, ndërsa për çështje teknike, kushdo që ka pasur harxhime të rrugës, fatura për benzinë e kështu me radhë ato do të refundohen te kolegja ime Dijana. Ndërsa, ju kisha lutur që ta marrim parasysh edhe propozimin e zonjës Greta që secili në mënyrën e vet të lutet një minutë. Ju faleminderit shumë! Kushdo që e ka nënshkruar deklaratën për bashkëngjitje mund ta lë në tavolinë, ndërsa për disa ditë do ta merrni edhe raportin nga ky takim me propozimet dhe mendimet tuaja në këtë temë. Ju faleminderit shumë dhe ju ftoj në drekë.